



**Kosovo Local Government Institute  
Local Governance Academy**



**Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale  
Akademia për Qeverisje Lokale  
*Gjenerata e parë***

*This Program is supported by the Friedrich Ebert Foundation Norwegian Embassy and British Council*



## Përmbledhje përmbajtësore Akademia për Qeverisje Lokale

“Akademia për Qeverisje Lokale” - AQL është trajnim i ndërtuar mbi përvojën, njohuritë dhe ekspertizën trivjecare të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale – IQL. Gjatë kësaj periudhe, IQL ka zbatuar me sukses projekte të natyrës vlerësuese, hulumtuese dhe trajnuese. Konkretisht, si pikë reference IQL ka pasur dhe do të ketë, në njërën anë, legjislacionin dhe politikat që rregullojnë qeverisjen lokale, ndërsa, në anën tjetër, kapacitetet institucionale dhe vendimmarrjen. Kështu, në mënyrë aktive IQL kërkon shtigje në të cilat mund të intervenohet nëpërmes iniciativave që forcojnë nivelin e qeverisjes lokale.

Nga sa u tha, AQL, nëpërmes moduleve trajnuese të cilat janë ofruar përmes ligjëratave, diskutimeve, punës në grupe dhe platformës për shkëmbim të përvojave dhe informacionit, është fokusuar në elaborimin dhe kristalizimin e konceptit modern të qeverisjes lokale në Evropë dhe rajon. Kjo i ka ndihmuar pjesëmarrësit në module, që të investojnë në avancimin e konceptit të qeverisjes lokale.

AQL ka ofruar mundësi krahasimi midis modeleve të ndryshme të qeverisjes lokale, nga demokracitë e konsoliduara dhe ato në rajon. Në këtë mënyrë, trajnimi i ka kontribuar elaborimit dhe analizimit të atyre attributeve dhe karakteristikave të modeleve të tjera, të cilat do të mund të shfrytëzoheshin dhe akomodoheshin në modelin e qeverisjes lokale në Kosovë.

AQL, në mënyrë kritike, por konstruktive, është marrë me shtjellimin, interpretimin dhe analizimin e politikave dhe legjislacionit që rregullon qeverisjen lokale në Kosovë. Si rezultat, pjesëmarrësit në këtë trajnim kanë pasur mundësi që, si nivel i veçantë i qeverisjes, kundrejt qeverisjes qendrore, të jenë ata të cilët dalin në mbrojtje, në promovim dhe avancim të këtij niveli. Adresimi i çështjeve legjislative dhe politikave, do t’ua mundësojë zyrtarëve dhe aktorëve të tjerë në nivel lokal që të mund t’i përdorin njohuritë dhe shkathtësitë e marra nga trajnimi, konform nevojave për adresimin e vështirësive dhe gjetjen e zgjidhjeve në proceset e qeverisjes.

AQL, në procesin e ofrimit të moduleve ka ofruar material mbi apskte të demokratizimit, përfshirjes dhe kohezionit social. Në esencë, kjo përshkon qeverisjen nëpërmes informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe akterëve në nivel lokal dhe më gjerë. Në këtë aspekt, trajnimi ndikon në konsolidimin demokratik në nivel lokal, por edhe në forcimin e lidhjes midis strukturave të zgjedhura/qeverisëse dhe të përfaqësuarve/qytetarëve. Në qeverisje demokratike parasheh praktika dhe procese, të cilat sigurojnë që strukturat qeveritare nuk shpëputen nga vullneti, shqetësimet dhe pritjet qytetare.

AQL, përmes këtij programi, që për synim ka ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme, ka për qëllim, veçanërisht, që t’i fuqizojë asambleistët e gjashtë komunave. Vlerësimet që dalin nga puna disavjeçare e IQL-së, tregojnë se asamblatë komunale nuk janë duke e ushtruar fuqishëm funksionin mbikëqyrës dhe monitorues ndaj fuqive zakonisht të mëdha dhe me tendencë në rritje të ekzekutivit dhe, veçanërisht, kryetarit. Para së gjithash, AQL ka për synim që të ngrisë bashkëveprimin dhe komunikimin midis këtyre akterëve kyç të qeverisjes dhe të demokracisë lokale në nivel komunal.

AQL, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit, rrjetëzimit dhe të vëzhgimit të drejtpërdrejtë në fushën e qeverisjes lokale në rajon, ka organizuar dhe punëtori në rajon.

Konkretisht dhe, në veçanti, programi AQL është dizajnuar nga profesionistë të fushës dhe personalitete me eksperiencë. Si i tillë, ky program ka trajtuar tema që në thelb shtrajnë nevojën për intervenim dhe përmirësim të gjendjes në fushën e qeverisjes lokale në terren. Mes tjerash, temat e programit kanë adresuar: 1. Parimet e Demokratizimit dhe ndërlidhjen me Decentralizimin; 2. Sistemin e Decentralizimit dhe Menaxhimin; 3. Konceptet e qeverisjes së mirë - ofrimin e shërbimeve komunale efikase; 4. Administratën Publike dhe parimet e saj; 5. Informimin, transparencën dhe llogaridhënien; 6. Rëndësinë e planifikimit buxhetor; 7. Komunitet v.s. Integrimin Evropian; 8. Përfshirjen qytetare - vendimmarrjen me pjesëmarrje; 8. Rolin e shoqërisë civile dhe të medias; 9. Bashkëpunimin ndërkomunal; 10. Barazinë dhe fuqizimin gjinor.

AQL është një program fleksibil, por në rritje e sipër. Në një të ardhme, programi ka për qëllim të mbulojë të gjitha komunat e Kosovës, por fillimisht programi ka përzgjedhur 12 komuna dhe 60 pjesëmarrës, të ndarë në dy grupe – Grupi I, Grupi II. Pjesëmarrësit janë zyrtarë vendimmarrës dhe përfaqësues – dega e ekzekutivit dhe legjislativit. Grupi I do të ketë komuna të prekura nga decentralizimi, komuna të vogla. 30% e pjesëmarrësve iu përkasin komuniteteve jo shumicë. 40% prej pjesëmarrësve janë femra.

Sinqerisht,

Besnik Tahiri  
Drejtor Ekzekutiv  
Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale

### Ligjëruesit

- Igor Gaon, Përfaqësues i Këshillit të Evropës;
- Leonora Kryeziu, PIPS;
- Sllobodan Petroviç, Zv/Kryeministër dhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Bajrush Xhemajli, Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës;
- Osnat Lubrani, Përfaqësuese Rezidente e UNDP-së;
- Lufti Haziri, Ish-ministër i MAPL-së;
- Prof. I'ta Odonovan - Ligjëruese në Universitetin e Birminghamit;
- Agron Maxhuni - Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL;
- Besnik Osmani - Sekretar i Përhershëm në MAPL;
- Nensi Jasharaj – Këshilltare Ligjore, Misioni i OSBE-së;
- Bardha Rrustemi, Drejtoreshë e Reformës së Administratës;
- Josip Juratevic - Parlamentar i Bundestagut Gjerman;
- Riza Halimi - Anëtar i Parlamentit të Serbisë;
- Rizvan Sylejmani – Ish-ministër i Pushtetit Lokal, Maqedoni;
- Donat Syla – Kryeredaktor, RTK;
- Bekim Salihu - Gazeta “Koha Ditore”;
- Arbër Gorani - Ligjërues në Kolegjin ISPE;
- Fisnik Rexhepi - Këshilltar i Lartë i Ministrisë të Punëve të Brendshme;
- Gjeneral Shpend Maxhuni - Drejtor i Policisë së Kosovës;
- Prof. Andrew Nickson - Universiteti i Birminghamit;
- Dr. Friedhelm Frishenschelager - Kryetar i Lëvizjes Federaliste Evropiane;
- Avni Sahiti – Drejtor, MAPL;
- Alba Dakoli-Wilson, Drejtoreshë e FLAG, Shqipëri;
- Prof. Donald Curtis – Specialist i Menaxhmentit Publik dhe Zhvillimit Insitucional;
- Kolonel Fahredin Verbofci;
- Gani Demaj- Ish Shef i Kabinetit, Ministria e Drejtësisë;
- Besnik Vasolli – Ekspert i Integriteteve Evropiane;
- Fatmir Haxholli - Ekspert i Integriteteve Evropiane;
- Sehadin Shok - Ekspert për të Drejtat e Njeriut;

## Profili i pjesëmarrësve

### Venera Shala:

Venera Shala, aktualisht është udhëheqëse e personelit dhe Sekretarisë së Kuvendit të Komunës së Junikut. Përvoja e saj e punës përfshin një periudhë afërsisht 5-vjeçare. Ka përfunduar Fakultetin Juridik, ndërsa synimi i saj profesional për të ardhmen është që të merret me degën e gjyqësorit.

Nga Akademia për Qeverisje Lokale, Venera pret që të fitojë njohuri të theksuara në fushën e qeverisjes lokale, dhe veçanërisht në aspekt të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale. Përshtypjet e saj fillestare, në lidhje me AQL-në, janë tërësisht pozitive. Interes të shtuar i ka zgjuar procesi dhe rëndësia e decentralizimit të shërbimeve nga niveli qendror drejt nivelit lokal.

Duke qenë në pozitë udhëheqëse të personelit si dhe organizimin e punëve të institucionit të përfaqësimit lokal, ajo ka shfaqur interes që AQL të trajtojë tema që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, përfshirë këtu marrëdhëniet njerëzore në kuadër të institucionit si dhe në punën me palë.

Venera shprehet se është tërësisht e përkushtuar që, si në nivel personal, ashtu edhe në nivel të institucionit, të angazhohet maksimalisht në forcimin dhe promovimin e qeverisjes lokale. Për këtë qëllim, ajo shprehet se do të aplikojë të gjitha njohuritë e saja akademike, përvojën profesionale dhe, veçanërisht, njohuritë e marra nga AQL. Si qytetare në moshë të re, Venera shprehet e bindur se është e pajisur me bindje, kurajë dhe energji në avancimin e një qeverisjeje përherë e më të avancuar dhe më demokratike në nivel lokal, respektivisht komunal.

### Shefkije Mehmeti:

Shefkije Mehmeti është kryesuese e Kuvendit Komunal të Novobërdës. Në këtë pozitë, Mehmeti është për vitin e tretë me radhë. Ka përfunduar shkollimin e mesëm në fushën ekonomike – Ekonomia Juridike – ndërsa shkollimin universitar në Universitetin AAB, në fushën e Administratës Publike. Shefkia shpreh aspiratën për të qenë në pozita kryesuese të Komunës së Novobërdës, si dhe të vazhdojë të mbetet një aktiviste e shquar e partisë politike, të cilës i përket. Në këtë drejtim, ajo beson se i plotëson të gjitha kualitetet për të qenë potencialisht edhe kryetare e komunës në një të ardhme jo të largët. Në këtë kuptim, ajo shprehet se ka përfutuar shumë përvojë dhe njohuri nga bashkëpunimi me kryetarin aktual të Komunës.

Nga AQL pret zgjerimin e njohurive në fushën e qeverisjes lokale dhe, specifikisht, pret shkëmbim të përvojave dhe njohurive nëpërmes ligjëratave, prezantimeve, komunikimit dhe punës në grupe me pjesëmarrës të tjerë në AQL. Përshtypjet e deritashme të Shefkijes e kanë bërë të besojë se AQL është një platformë e pazëvendësueshme në fushën e qeverisjes lokale. Konkretisht, shprehet të jetë tejet e kënaqur më trajtimin e temave që lidhen me legjislacionin primar dhe sekondar që rregullon fushën e qeverisjes lokale. Në këtë drejtim Mehmeti shpreson se, krahasimi i legjislacionit të Kosovës në fushën e qeverisjes lokale, me legjislacionin e vendeve të rajonit dhe më gjerë, do t'iu ndihmonte zyrtarëve komunalë që të kuptojnë më mirë përparësitë dhe mangësitë në të cilat ata operojnë.

### **Driton Abdyli:**

Driton Abdyli angazhohet në pozitën e Nënkryetarit të Komunës së Novobërdës. Abdyli ka një përvojë shumëvjeçare politike si sekretar administrativ i Degës së LDK-së në këtë komunë. Abdyli ka përfunduar Fakultetin Ekonomik, dega Banka, Financa dhe Kontabilitet. Synimet e tij lidhen me avancimin e mëtejshëm akademik në fushën e ekonomisë, me theks menaxhmentin.

Nga AQL pret përfitim të njohurive të reja në lidhje me organizimin e pushtetit lokal në përgjithësi dhe, veçanërisht, mënyrën e funksionimit, zhvillimit dhe avancimit të këtij pushteti në Kosovë, duke u bazuar në përvojat e shteteve dhe të sistemeve më demokratike në Evropë e në botë. Përshtypjet dhe mësimet e nxjerra nga vijimi i akademisë, Abdyli i ndërlidhë ngushtë me rëndësinë e përfitimit nga ligjëratat e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Në këtë kuptim, shprehet se përshtypje të theksuar i ka bërë procesi i vendimmarrjes së bazuar në konsultim dhe evidencë, diçka që, sipas tij, do t'i ndihmojë pjesëmarrësit e AQL-së që t'i kontribuojnë dhe të angazhohen në një qeverisje të mirëfilltë demokratike, të karakterizuar me transparencë dhe llogaridhënie.

Pritje e Dritonit nga AQL është që të trajtohen hollësisht temat ekonomike dhe financiare. Në këtë mënyrë, Dritoni thekson se do të mund të ndikohej më shumë në menaxhimin e shëndoshë me financa dhe në përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe sociale në nivel të komunave. Në moshë të re dhe me përvojë të theksuar, Abdyli beson se posedon gjithë çfarë i duhet një kuadri për të ndryshuar pozitivisht të ardhmen e komunës dhe të vendit.

### **Agim Preniqi:**

Agim Preniqi shquhet për një përvojë pune 30-vjeçare. Si jurist i diplomuar, Preniqi aktualisht angazhohet në pozitën e Drejtorit të Njësisë së Ujësjetës Rajonal KUR “PRISHTINA”, në Obiliq. Synim parësor i tij është t'i shërbejë zhvillimit të ujësjetës, por, njëkohësisht, t'i përcjellë trendet politike në mënyrë që politikisht të mund të ofrojë kontributin e tij në përmirësimin e qeverisjes lokale.

Nga AQL pret rifreskimin e njohurive, përfitimin dhe shkëmbimin e përvojave, në mënyrë që të mund t'i përkthejë ato njohuri dhe përvoja në rezultate konkrete qeverisëse, në dobi të qytetarëve të komunës, por edhe më gjerë. Preniqi thekson se do të ishte tejet e rëndësishme që, në kontekst të zhvillimeve politike në nivel të Kosovës dhe, specifikisht, të atyre lokale, të trajtoheshin tema që lidhen me kulturën politike – sikurse janë toleranca politike, organizimi dhe menaxhimi i marrëdhënieve institucionale dhe atyre politike. Në këtë kuadër, është me rëndësi të përmenden marrëdhëniet midis institucionit të Kryetarit kundrejt Kuvendit të Komunës, si dhe marrëdhëniet e mazhorancës kundrejt opozitës.

Preniqi shprehet se posedon një kombinim të shkëlqyer të përgatitjes profesionale dhe të përvojës nga terreni dhe, gjithashtu, duke qene në moshë të mesme, ai beson se mund të shërbejë si urë lidhëse midis atyre personaliteteve që i përkasin lidhësit të moshave më të shtyra dhe gjeneratave të reja. Në këtë drejtim, Preniqi konstaton se gëzon respektin e të gjithë stafit komunal, si dhe të përfaqësuesve të partive të ndryshme politike dhe atyre të shoqërisë civile.

**Nazmi Sijarina:**

Nazmi Sijarina posedon një përvojë të gjatë në disa fusha, si: arsimi, administrata dhe burimet njerëzore. Pozita aktuale e Sijarinës është zyrtar i lartë për prona në minierat Kishnicë dhe Artanë si dhe anëtar i KK dhe KPF në Komunën e Artanës. Gjithashtu, që nga viti 2000, Sijarina është Kryetar i Degës së PDK-së në Artanë. Ka përfunduar gjimnazin, ndërsa, për shkak të vështirësive objektive, nuk ka mundur t'i përkushtohet më tej jetës studimore dhe akademike.

Sijarina thekson se ka dy qëllime kryesore për të ardhmen, respektivisht ngritjen profesionale dhe forcimin e karrierës së tij politike në nivel lokal dhe vendor. Përshtypjet dhe mësimet e nxjerra nga vijimi i akademisë, i vlerëson si shumë pozitive. Sijarina shprehë interes të theksuar që të përcjellë ligjërata dhe prezantime të ekspertëve ndërkombëtarë, duke qenë se i mundësojnë krijimin e një perspektive më të avancuar dhe më krahasimtare në lidhje me qeverisjen lokale në Kosovë.

Sijarina është një personalitet i njohur për banorët e komunës dhe më gjerë. Ai vlerësohet lartë nga bashkëpunëtorët e tij në Komunë – vijues të AQL-së – si dhe nga pjesëmarrësit tjerë në AQL. Nazmiu shprehet se do të përdorë gjithë rrjetin e tij social dhe politik në fuqizimin e proceseve lokale në Kosovë, ndërsa thekson se angazhohet që të transmetojë përvojat e mira të qeverisjes te brezat e rinj.

**Dionita Tahiri:**

Ka një përvojë relativisht të re në Kuvendin Komunal. Aktualisht shërben si këshilltare në Kuvendin Komunal. Në një moshë të re Tahiri ka vendosur që, krahas vijimit të studimeve universitare në Fakultetin e Filologjisë, ku ka absolvuar, dhe Fakultetin Ekonomik në vitin e parë të studimeve, të angazhohet edhe politikisht.

Dionita angazhohet në punën në komisione të Kuvendit Komunal dhe merr pjesë në shumë trajtime dhe konferenca në lidhje me qeverisjen lokale. Synim parësor i ka vënë vetes të avancojë profesionalisht dhe politikisht. Tahiri i vlerëson lartë njohuritë dhe përvojat që ofron AQL, por shprehet se vlen të konsiderohet zgjerimi i hapësirës kohore për diskutime të hapura dhe në grupe më të vogla. Një temë, të cilën ajo e preferon të trajtohet më interes të theksuar, do të ishte fuqizimi dhe barazia gjinore.

Duke qenë se i përket brezit të ri, Tahiri e vlerëson shumë përvojën që mund të përfitojë nga pjesëmarrësit me një përvojë më afatgjatë në fushën e qeverisjes lokale. Ndërsa, në lidhje me ligjëratat, prezantimet dhe diskutimet nga ligjërues dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, ajo shprehet se ato po ndodhin në një moment shumë të volitshëm për ngritjen e saj në karriere, si dhe në intensifikimin e aktiviteteve të saj në fushën e qeverisjes lokale.

### **Mirvete Haxholli:**

Mirvete Haxholli angazhohet në pozitën e Këshilltares në Kuvendin Komunal në Kastriot. Njëkohësisht, ajo është edhe staf i Raiffeisen Bank J.S.C – Senior CRO/TELLER në këtë Komunë. Mirveteja ka përfunduar Shkencat Politike në Universitetin e Prishtinës. Posedon një përvojë të gjatë në punë me organizata dhe kompani vendore, sikurse Norëegian Association of Local and Regional Authorities – KS Kosova dhe INKOS. Haxholli njihet si një aktiviste e shquar politike në këtë komunë, ndërsa synimet e saj për të ardhmen janë pjesëmarrja aktive në politikë si dhe ngritja kapaciteteve profesionale përmes vazhdimit të studimeve postdiplomike në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Nga AQL pret zgjerimi i njohurive në fushën e qeverisjes lokale, njohjen më për së afërmi me përvojat e rajonit dhe përvojat e ngjashme të vendeve të zhvilluara perëndimore, alternativat për të ardhmen si dhe planifikimi i hapave të sigurt profesional të ngritjes së kapaciteteve komunale. Për AQL-në shprehet se është një nismë pozitive dhe inkurajuese, dhe një program unikat që tani për tani do të mund të ofrojë diçka shumë profesionale dhe premtuese për ngritjen e kapaciteteve në nivelin lokal të qeverisjes, duke garantuar kështu mundësi të zhvillimit profesional në baza individuale dhe ekipore.

Në këtë kuptim, Mirveteja thekson se AQL meriton komplimente për kontributin që është duke e dhënë në këtë aspekt dhe po i paraprinë ngritjes së shërbyesve civilë të përgjegjshëm, si dhe një pushteti lokal më transparent dhe llogaridhënës, i cili reflekton në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe ndërtimin e besimit reciprok – institucione kundrejt qytetarëve. Haxholli vlerëson se do të ishte me interes të organizoheshin vizita me qëllim shkëmbimin e përvojave në rajon dhe Evropë.

### **Kushtrim Mirena:**

Angazhohet në Zyrën për Integritet Evropiane pranë Kuvendit Komunal të Obiliqit. Përvoja paraprake e tij ka qenë në fushën e teknologjisë informative si këshilltar në Korporatën TPlusOil. Ka përfunduar shkollimin universitar në UP, FSHTAM Informatike Telekomunikacion; Universiteti AAB-RIINVEST, Fakulteti Juridik, si dhe Shkollën e Integriteteve Evropiane – Kas, përfshirë këtu edhe shkollimin pranë AUK - Rrjetat e Informacionit Cisco.

Mirena ka si synim profesionalizimin e mëtejshëm në fushën e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale, dhe beson se AQL do t'i ndihmojë përgatitjes së tij në realizimin e këtij qëllimi. Vlerëson si shumë pozitive mundësinë që do të ofrojë AQL nëpërmes vizitave studimore në rajon. Në këtë kontekst, Mirena shpreson se do të mund të marrë informacion të dorës së parë në lidhje me përvojat dhe praktikën e vendeve të rajonit në përparimin e integriteteve evropiane, si dhe ndërlidhjen e tyre me qeverisje lokale.

Mirena shpreh interes që AQL të ofrojë trajnime në lidhje me përgatitjen e projekt-propozimeve me qëllim përfitimin e fondeve në përkrahje të proceseve komunale.



**Fatmir Matoshi:**

Aktualisht angazhohet si kryeredaktor në Radio Premiera. Posedon një përvojë të gjatë në fushën e qeverisjes dhe të medias. Ka shërbyer edhe si Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit – KK Kamenicë 2004 – 2006 dhe korrespondent i BBC në Gjuhën Shqipe, 2007-2010.

Matoshi ka për synim avancimin profesional në Gazetari si dhe të merret me çështje praktike në terren, përfshirë këtu ngritjen e kapaciteteve njohëse në lidhje me funksionimin e pushtetit lokal në Kosovë dhe në rajon. Nga AQL pret përfitime praktike të përvojave të fushës së Qeverisjes Lokale, përmes ligjëratave të ekspertëve të fushës së qeverisjes lokale si dhe njohja më e drejtpërdrejtë me legjislacionin në fuqi, që e rregullon këtë fushë.

Matoshi nënvizon se, duke qenë se pjesa absolutisht më e madhe e pjesëmarrësve dhe ligjëruesve janë zyrtarë lokalë ose ekspertë të pushtetit lokal, deri më tani përshtypja është se temat e trajtuara kanë qenë mjaft të dobishme edhe për shkak të debateve që kanë ngjallur në mes të pjesëmarrësve. Përfaqësues të komunave të ndryshme kanë dhënë shembuj të ndryshëm dhe praktikë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Matoshi vlerëson se AQL duhet që të përfshijë në një nivel sa më të theksuar edhe pjesëtarë të shoqërisë civile, studentë dhe grupe të tjera. Një temë të cilën ai e vlerëson si me shumë interes dhe ndjeshmëri për proceset e qeverisjes lokale është trajtimi i bazës ligjore për partneritetin publiko-privat dhe mundësinë e këtij partneriteti në nivelin lokal dhe marrëdhëniet me publikun.

**Menduh Vllashi:**

Aktualisht, Menduh Vllashi është Kryesues i Kuvendit të Komunës në Han të Elezit. Posedon një përvojë të gjatë të punës si arsimtar i Kimisë në shkollën fillore “Ilaz Thaçi”, në Han të Elezit, dhe nga viti 1993 deri më 2005 si Drejtor i kësaj shkolle. Nga tetori i vitit 2005 është edhe Zv/Kryetar i Komunës në Han të Elezit.

Vllashi vlerëson lartë programin e AQL-së, ndërsa thekson se ai është thellësisht i interesuar në debatimin e temave, në mënyrë që të vlerësohen dhe kontekstualizohen sa më objektivisht informacionet, praktikat dhe të dhënat në lidhje me qeverisjen lokale në komunat nga vijnë pjesëmarrësit. Fushë me interes te veçantë, ku Vllashi do të dëshironte të përfitonte, është trajtimi i funksionimit të kuvendeve të komunave në rajon dhe më gjerë, raportet midis degës së kuvendit dhe ekzekutivit; roli i kuvendeve të komunave për një qeverisje të mirë në interes të qytetarëve; transparenca e punës së ekzekutivit ndaj kuvendit dhe qytetarëve.

Vllashi angazhohet për ndërtimin e një shërbimi civil dhe një administrate sa më profesionale, në të gjitha nivelet, ndërsa sa i përket Komunës së Hanit të Elezit, ai thekson se stafi i komunës angazhohet në konsultimin dhe përfshirjen e qytetarëve si dhe zgjerimin e shërbimeve. Pavarësisht, ai thekson se gjatë përvojës së tij, shpesh hasë në vështirësi që lidhen me mungesë të kapaciteteve profesionale, financiare dhe teknike. Për këtë qëllim, ai mirëpret që në të ardhmen AQL të trajtojë tema që lidhen me ofrimin e shërbimeve dhe planifikimit buxhetor.

### **Ajete Berisha:**

Ajete Berisha shërben në pozitën e udhëheqëses së Personelit në Komunën e Hanit të Elezit. Ka përfunduar fakultetin në fushën e Administratës Publike - Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë, Maqedoni. Fushë me interes profesional për të është Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, ku ajo synon që në të ardhmen të ligjërojë.

Nga AQL pret thellimin e përvojës në lidhje me atë se cili duhet të jetë relacioni në mes të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes lokale, njohje më të mirë të reformimit të administratës publike, si të arrijmë që të kemi një shërbim civil të paanshëm, profesional, të përgjegjshëm.

Përshtypja e saj e deritashme është që ligjëratat dhe prezantimet nga profesorë dhe ekspertë të vendeve perëndimore i kanë ndihmuar asaj të ketë një këndvështrim më të avancuar dhe krahasues në lidhje me gjendjen e qeverisjes lokale në Kosovë. Temat me interes të veçantë për të do të ishin temat sikurse Menaxhimi i Resurseve Njerëzore në rajon; eksperiencia të qeverisjes lokale efikase nga vendet e rajonit, komunikimi efikas në mes të qeverisjes qendrore dhe asaj lokale.

### **Abdyl Bajrami:**

Aktualisht mban postin e Nënkyetarit të Komunës së Vitisë, këshilltar i Kuvendit Komunal Viti. Ka përfunduar Fakultetin e Elektroteknikës pranë Universitetit të Prishtinës. Përvoja e tij ka të bëjë me aspektin menaxherial. Ka qenë drejtor i ndërmarrjes Banja e Klllokotit. E veçanta e përvojës së tij politike është se ka marrë mandatin e këshilltarit Komunal, nga kandidimi si kandidat i pavarur. Kjo përvojë e zgjedhjes është shumë e rrallë.

Bajrami, nga AQL ka parë modele të reja të bashkëpunimit të komunave me qytetarët, përshtypje të mëdha ka marrë nga ligjërimi për përvojën e demokracisë së hershme dhe të konsoliduar angleze. Si mision të tij ka përkushtimin ndaj zgjedhësve dhe të qenit sa më afër elektoratit dhe qytetarëve. Bajrami beson se në rast se politikat nuk burojnë nga poshtë-lart, atëherë zbatimi i tyre përcillet me vështirësi. Sipas tij, ndërtimi i këshillave konsultativë në komuna, i rregulluar me ligjin për vetëqeverisje lokale është objektiv shumë i mirë që duhet të arrihet.

Bajrami angazhohet që qeverisja lokale të fuqizohet nëpërmes vizionit të qartë politik dhe të teknokracisë. Politika duhet të mbahet përgjegjëse që të ofrojë vizion qeverisës për mandatin dhe të paraqesë planin qeverisës, duke përfshirë afatet kohore dhe dinamikën e zbatimit. Teknokracia duhet të jetë në shërbim të vizionit politik e, gjithashtu, të jetë e pavarur dhe e pandikuar në punën profesionale që bënë. Ndarja e përgjegjësive dhe detyrave siguron efikasitet të plotë.

**Albulena Haxhiu:**

Aktualisht mbanë pozitën e këshilltares së lartë juridike pranë zyrës së Kryetarit të Komunës. Haxhiu ka përfunduar studimet postdiplomike, respektivisht magjistraturën në shkencat juridiko-penale. Përvoja e saj e punës ka dimension të gjerë, si rezultat i angazhimit të saja dhe cytjes për punën që bën. Haxhiu ka qenë i angazhuar në Misionin Evropian për sundimin e Ligjit (EULEX) si legal officer, dhe si gazetare në OJQ Elita. Qasja në studimet e doktoratës dhe absorbimi i titujve shkencorë, me theks tek njohuritë e thelluara profesionale me karakter të privilegjuar, janë synimet e saj profesionale.

Për Haxhiun, AQL po shërben si platformë e mirë për shkëmbim përvojash dhe njohurish nga fusha e qeverisjes lokale. Mosha, ambiciet dhe përkushtimi, të ndërthurura dhe me përvojën e Albulenës, i japin një karakter të veçantë, energjik dhe shumë inovativ në aspektin e zhvillimit institucional.

Nga AQL, Haxhiu pret që zhvillimet në aspektin e qeverisjes lokale të trajtohen nën dritën e përparësive dhe mangësive, përfshirë këtu dhe aspektin kronologjik. Sipas saj, procesi i ndërvarshmërisë në aspektin e zhvillimit të politikave publike dhe harmonizimi i këtyre politikave kanë role të veçantë në evoluimin e qeverisjes lokale.

**Besim Halimi:**

Është drejtor i Administratës së Përgjithshme KK –Viti. Ka përfunduar magjistraturën në shkencat juridike. Duhet përmendur se studimet e koplementarizuara me përvojën e punës, kanë bërë që të ketë sukses të shquar në fushën e funksionalizimit, menaxhimit dhe reformimit të administratës. Duke qenë aktiv në jetën politike, Halimi synon t'u ofrojë qytetarëve përkushtim dhe shërbim për besimin e dhënë. Synim i tij afatshkurtër është vazhdimi i studimeve në nivel të doktoraturës.

Programi i AQL-së për Halimin mundëson përfitimin në shkëmbim të përvojave të reja, që i shërbejnë atij në forcimin e qeverisjes lokale. Për më shumë, sjellja dhe elaborimi i modeleve qeverisëse lokale nëpërmes ligjëratave do të kenë impakt të drejtpërdrejtë si në aspekt të nxjerrjes së mësimëve, ashtu edhe në forcimin e një qasjeje më inovative dhe llogaridhënëse të zyrtarëve kundrejt qytetarëve. Në vija të trasha, organizmi i pushtetit lokal është me interes të veçantë për Halimin, ndërsa AQL është një mundësi ideale për Halimin.

Njohja e përvojave të reja, do të shërbejë dhe me tutje në ngritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Sektori i menaxhimit të resurseve humane, monitorimi dhe vlerësimi i punës janë tema që duhet spikatur nga AQL. Në angazhimin e tij, Halimi udhëhiqet nga efikasiteti dhe përkushtimi për qytetarin. Përkushtimi i tij politik dhe institucional është misioni i tij për avancimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve.

### **Blerta Lokaj :**

Aktualisht punon në kuadrin e drejtorisë për zhvillim ekonomik, më specifikiisht në zyrën për biznese. Ka përfunduar fakultetin e biznesit në Pejë dhe posedon një përvojë afërsisht 4-vjeçare në këtë fushë. Synimet e Lokajt konsistojnë në atë që përtej ofrimit të rolit dhe kontributit të saj në të mirë të jetës institucionale dhe publike, ajo thekson se ka një zell në fushën e ekonomisë dhe të biznesit. Në këtë drejtim, një nga synimet e saj për të ardhmen është angazhimi në fushën e biznesit.

Lokaj thekson se, duke u angazhuar në aspektin e zhvillimit ekonomik, dhe kryesisht në zyrën për biznese, e sheh sa e rëndësishme është puna e institucionit në dimensionin e zhvillimit ekonomik lokal. Sipas saj, planet e zhvillimit ekonomik dhe atij sektorial janë me interes të madh për komunat, duke përfshirë këtu hapat që fillojnë nga propozimi i konceptit, zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit.

Lokaj beson se AQL shërben si busullë në aspektin e orientimit, të zhvillimit të karrierës dhe, veçanërisht, sa i përket aspektit të qeverisjes lokale. E rëndësishme për Lokajn është forma praktike e shpjegimit dhe qartësimi i proceseve që trajtohen. Politikave publike, me theks atyre të zhvillimit ekonomik, duhet t'u kushtohet vëmendje. Praktikant nga vendet tjera na shërbejnë shumë, sidomos ato të atyre që kanë kaluar së bashku me ne aq shumë ndryshime në aspektin e politikave liberale ekonomike. E rëndësishme për ne është të ofrojmë infrastrukturën dhe të jemi të shpejtë në çështjet procedurale për bizneset, ngase drejtpërdrejt japin efektin e zgjedhjes së punësimit për qytetaret tanë.

### **Fari Kalisi:**

Aktualisht është i angazhuar në pozitën drejtor i Administratës në Komunën e Hanit të Elezit. Ka përfunduar Fakultetin e Edukimit. Në të kaluarën ka shërbyer si pjesëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Një objektiv i rëndësishëm në aspektin profesional është përfitimi i përvojave të reja lidhur me punën dhe modelet që shërbejnë në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe administratës.

Trajtimi i temave dhe studimet e bëra nga AQL përfaqësojnë modele të avancuara, që mund të shërbejnë si praktika të mira për avancimin e ofrimit të shërbimeve. AQL me modulet është duke trajtuar temat në rrjedhë dhe sinkroni, e që si rezultat është duke na ndihmuar që të kuptojmë rolin që kemi përballë qytetarëve dhe raportin që kemi me institucionet tjera.

Kalisi mirëpret që AQL të trajtojë aspekte specifike, që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të shërbimit e, posaçërisht, të mësojmë në lidhje me krijimin e një administrate të reformuar dhe efikase. Me pak fjalë, shkëmbimi i përvojave profesionale dhe atyre akademike, paraqet një ndihmesë të madhe për punën e secilit zyrtar komunal.

**Hajriz Bekteshi:**

Aktualisht ushtron funksionin kryesues të Kuvendit Komunal në Obiliq. Ka përfunduar Shkollën e Lartë, Gjuhë Shqipe, dhe shkollën e parë në Fakultetin Ekonomik. Shquhet për një përvojë të gjatë shërbimi në jetën politike dhe atë publike. Synimet e tij profesionale lidhen kryesisht me aspektin e reformimit të modeleve të reja politike në nivel të qeverisjes lokale.

Çështjet, si udhëheqja e kuvendeve komunale, marrëdhëniet e tyre me ekzekutivin dhe bashkërendimi i përpilimit dhe analizimit të zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve që dalin, janë disa nga sfidat e veçanta me të cilat ne ballafaqohemi. AQL, nëpërmes trajtimit me përgjegjësi të temave të fushave të ndryshme të qeverisjes lokale, ekspertiza që ofrohet, si dhe njohuritë e ofruara, i shërbejnë të ardhmes së komunikimit të ndërsjellë, ngritjes së nivelit demokratik dhe fuqizimit të institucioneve.

Nga AQL, Bekteshi pret që dhe më tutje të trajtohen tema specifike që kanë të bëjnë me ofrimin e rregulloreve në përputhje, dhe duke respektuar specifikat e secilës komunë. Veçanërisht, ndihme e theksuar në fushën e qeverisjes lokale do të ishte trajtimi i aspekteve, që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve në procese si dhe përmirësimin e proceseve vendimmarrëse. Aspekt me rendësi të veçantë është edhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies dhe përgjegjësisë në raport me qytetarët.

**Lulzim Canaj:**

Aktualisht mban pozitën e Zv/kryetarit të Komunës së Ranillugut. Ka përfunduar Fakultetin Juridik dhe magjistraturën në fushën e të Drejtës Penale. Për 6 vjet radhazi është angazhuar në departamente të ndryshme përbrenda institucionit të komunës, duke përfshirë administratën, shërbimet publike, gjeodezinë dhe kadastrën. Synimet e tij profesionale, kryesisht, lidhen me avancimin e karrierës profesionale.

Nga AQL me prioritet janë mësimet e nxjerra nga fusha e administratës, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve, menaxhimin e burimeve profesionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, duke pasur parasysh se kemi kaluar në shumë reforma, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë të ndërtimit institucional. Komunat shumetnike, përpos dallimeve në dimension administrativ, kanë edhe veçori në aspekt të profilit të stafit dhe bashkëpunimit në ofrimin e shërbimeve të gjithë qytetarëve.

Për Camajn, në të ardhmen, përvojat e marra nga AQL do të shërbejnë në disa drejtime, duke përfshirë atë të lidhshmit komunal e, po ashtu, edhe në aspektin menaxherial. Ngritja e kapaciteteve komunale ka një rendësi të veçantë, ngase aty është pikëtakimi ku qytetari ballafaqohet me zyrtarët dhe institucionet, për të adresuar shqetësimin, realizuar të drejtat apo përmbushur obligimet. Deri më tani, institucionet lokale kanë pasur ndryshime në aspektin përmbajtësor, duke përfshirë zgjedhjen e kuvendit dhe të kryetarit. Mbetet të shpresohet që në bazë të përvojës që kemi fituar, do të bëjmë ndryshime thelbësore, që lidhen drejtpërdrejt në efikasitet dhe eficiencë.

### **Mevlud Brava:**

Aktualisht shërben në pozitën e shefit të Protokollit dhe asistentit të Kryetarit. Është student në Universitetin Iliria, ndërsa me herët ka shërbyer në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës. Pritjet e Bravës janë ngritja e kapaciteteve në shërbimin civil dhe atë institucional.

Duke trajtuar temat, që kryesisht kanë të bëjnë me relacionet në mes të kuvendit dhe ekzekutivit, nivelit qendror dhe atij lokal, komunikimi me publikun dhe qytetarët janë tema nëpërmes të cilave AQL i ka kontribuar shumë ngritjes së kapaciteteve të pjesëmarrësve në trajnim. Komunikimi në aspektin e sjelljes dhe përfaqësimit ka një rëndësi të veçantë për Bravën, dhe i ndihmojnë atij në ofrimin e shërbimeve në kuadër të zyrës së kryetarit.

Nga AQL pres që të trajtohen temat e sjelljes protokollare, ngase në Kosovë, në këtë fushë, ka mangësi të mëdha. Organizimi dhe trajtimi i temave mendoj se duhet të ketë edhe aspektin protokollar dhe të sjelles institucionale. Kjo, së bashku me reformat e administratës, kanë rol të theksuar në ofrimin e shërbimit dhe të sjelljes në raport me publikun dhe qytetarët.

### **Naim Qerkezi:**

Angazhohet në Komunën e Obiliqit, pranë zyrës së Kryetarit. Qerkezi ka përfunduar studimet në Universitetin AAB-Riinverst. Më herët ka punuar në Presidencë. Kjo i ka shërbyer si përvojë e mirë në jetën institucionale. Synim i tij parësor është që, përmes përkushtimit dhe performacës, të avancojë karrierën e tij profesionale. Misioni i tij është që t'i fuqizojë kapacitetet e reja, që do t'i shërbejnë në punën e Komunës.

Qerkezi brenda Komunës së Obiliqit ka sjellë një qasje dhe dinamikë të re në punë. Qerkezi thekson se është i përkushtuar në reformat e pushtetit lokal, ndërsa në këtë kuadër pret që AQL t'i shërbejë si udhërrëfyes për kristalizimin e ideve të tij për ngritjen e kapaciteteve në pozicionin ku ai shërben.

Përvojat e reja i japin Qerkezit një kuptim të qartë në aspektin e reformave dhe fuqizimit të komunave. Në aspektin e ushtrimit të kompetencave dhe misionit që ka komuna, që të jetë më afër qytetarëve dhe t'u shërbejë atyre, AQL është duke ofruar dhe elaboruar praktikrat dhe modelet më të mira në fushën e qeverisjes lokale. Modelet dhe aspekti krahasimtar me vendet tjera, që tashmë kanë kaluar nëpër këtë proces, do të jenë një lehtësim i madh në rrugën e ndërtimit institucional dhe ngritjes së demokracisë. AQL është duke ofruar një platformë krahasuese të modeleve të ndryshme të qeverisjes lokale nga vende të ndryshme.

**Naim Kuqi:**

Aktualisht mban pozitën e drejtorit në Komunën e Junikut. Kuqi shquhet me një përvojë 25-vjeçare në fushën e menaxhmentit. Aspekti i ngritjes profesionale ka të bëjë me rolin e zbatimit të ligjit dhe përkushtimit për ngritjen e performacës së administratës. Menaxhimi i mirë duhet të jetë objektiv kryesor i secilës komunë, sepse kjo ndikon drejtpërsëdrejti në fuqizimin e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore.

Kuqi nga AQL ka përvetësuar njohuri dhe metoda të reja të zbatueshme, si në aspektin teorik dhe në atë të zbatueshmërisë apo teknik. Menaxhimi i resurseve ekzistuese dhe shpërndarja e detyrave në bazë të përvojave dhe kualifikimeve të stafit, ofron rezultate të sigurta. Zbatimi i ligjshmërisë me përpikëri ndërton marrëdhëniet e besimit midis institucioneve dhe qytetareve. Përkushtimi thelbësor për detyrat e dhëna, ka ndikuar në sukseset e synuara, ndërsa formaliteti pa përkushtim të trajtimit të detyrave, degradon procesin dhe e rrezikon atë në tërësi.

Nga AQL në të ardhmen presim të vazhdojë t'i trajtoj temat në thelb, duke shpjeguar shumë qartë si shkaqet ashtu edhe pasojat që ndodhin në qeverisjen lokale. Duhet marrë parasysh modelin qeverisjes me sistemin e të hyrave, mjedisin ku zhvillohen politikat. Mënyra e sjelljes politike dhe kultura qeverisëse, kanë rol të madhe në praktikat perëndimore, ndërsa ne si vend duhet t'i përshtasim politikat më shumë me kulturën politike.

**Ramush Mehmeti:**

Aktualisht është këshilltar komunal në Komunën e Novobërdës. Mehmeti ka studiuar në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë. Ka përvojë të gjatë institucionale dhe menaxhuese, ka punuar ne kooperativen bujqësore në Prekoc. Gjithashtu, ka qenë i angazhuar në kuadër të OSBE-së, në kontrollin e dokumentacionit. Paraprakisht, ka shërbyer si drejtor i Drejtoratit të Bujqësisë, nënkryetar komune dhe, po ashtu, në Bankën Ekonomike ku ka mbajtur pozitën e analistit të kredive. Synimet e tij profesionale janë që, së bashku me bagazhin e përvojës dhe atë akademik, të përvetësojë dhe aplikojë sa më mirë format e avancuara të menaxhimit. Gjatë kohës së organizimit të moduleve të deritanishme, Mehmeti shprehet se është shumë i kënaqur me informacionin dhe ligjëratat e ofruara nga AQL.

Me interes të veçantë është çështja e menaxhimit dhe aspektet që kanë dalë si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur në sistemin e qeverisjes lokale. Për Mehmetin është e rëndësishme të arrijë njohuri të reja në fushën e menaxhimit dhe, veçanërisht, ofrimin në shfrytëzim të pronave publike, me qëllim mundësimin e zhvillimit lokal në komunën ku ai punon. Iniciativat atraktive në praktikat rajonale dhe më gjerë, janë të rëndësishme, ndërsa, në lidhje me këtë, Mehmeti propozon që AQL të organizojë sa më shumë vizita njohëse dhe studimore.

### **Riad Sadiku:**

Aktualisht është Këshilltar në Kuvendin Komunal, ndërsa në nivel privat ofron shërbime juridike në Viti. Gjithashtu, është edhe kryetar i Këshillit Rinor në Komunën e Vitisë. Ka kryer studimet në nivel të magistraturës në Shkencat Kushtetuese - Administrative. Komplementarizimi i aspektit të të qenit afër të rinjve dhe njohja e problemeve të tyre reale, puna në ofrimin e shërbimeve juridike si mision i veçantë për ndërtimin e shtetit të besimit dhe së drejtës, shkollimi në fushën e ndërtimit kushtetues-administrativ, kanë bërë që Sadiku ta ndjejë veten obliguar që t'u shërbejë qytetarëve në jetën politike.

AQL duhet të vazhdojë të shërbejë në qartësimin e vizionit të të trajnuarve, në mënyrë që ata t'ju shërbejnë qëllimeve që përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve. Fushat me interes të veçantë dhe pritjet specifike të Sadikut nga AQL, kryesisht lidhen me fushën e ngritjes së kapaciteteve të administratës, reformën dhe ofrimin e shërbimeve cilësore qytetarëve. Relacioni në mes të pushtetit lokal dhe qendror, niveli i harmonizimit dhe bashkëpunimit, janë me interes të veçantë për Sadikun.

Riadi shprehet se është tërësisht i përkushtuar në misionin që i ka caktuar vetes dhe se bashkëpunimi dhe bashkërendimi i agjendave që ndihmon në përmirësimin e jetës së qytetarëve, për të janë shumë të rëndësishme. AQL, në të ardhmen, pret t'i shërbejë në aspektin e planifikimit të politikave dhe zbatimit të tyre me qasje sa më pragmatike dhe arritja e objektivave në mënyrë sa më efektive.

### **Sinan Gacaferri:**

Aktualisht punon në pozitën e kryesuesit të Kuvendit Komunal në Junik. Ka përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike. Posedon një përvojë të gjatë profesionale. Synimet e tij profesionale janë avancimi i përvojës në politike dhe asaj në aspektin pedagogjik. Kryesimi i Kuvendit Komunal është, njëkohësisht, privilegj dhe sfidë. Problemet politike në Kosovë dhe niveli i demokracisë ende janë në stadi fillestar. Aspekti i komunikimit dhe bashkëpunimit në mes të spektrit politik, karakterizohet nga mangësi të theksuara, ngase politikat ditore janë ato që më së tepërmi trajtohen.

Gacaferri nga AQL pret që të trajtohen temat e decentralizimit, fuqizimi i kuvendeve komunale, bartja e kompetencave shtesë nga niveli qendror. I rëndësishëm është edhe procesi i ngritjes së dialogut dhe debatit nëpër kuvendet komunale. Aspekti formal i qasjes në problematika, ka bërë që të mos trajtohen temat ashtu siç duhet. Për Gacaferri, ngritja e nivelit të demokracisë, debatit dhe e përkushtimit të përfaqësuesve të zgjedhur, është shumë e rëndësishme dhe, njëkohësisht, duhet nënvizuar që ndjenja e përgjegjësisë e secilit për problemet dhe hallet e qytetarëve, duke kaluar kufijtë e aspektit partiak, duhet kthyer në praktikë.

Pritjet nga AQL janë shtjellimi i temave konkrete dhe praktike që na shërbejnë shpejt për t'i vënë në funksion, forma se si e kanë kaluar tranzicionin vendet e rajonit, Kosova si një vend post-tranzicional, si në aspektin ekonomik dhe atë të sistemit politik. Ndërtimi i kapaciteteve institucionale kërkon sakrificë dhe mund, ndërsa përkushtimi dhe idealet e larta janë ato që na shpiejnë përpara. Aspekti i komunikimit dhe përkushtimi i stafit në AQL-së është për çdo respekt.



**Vllaznim Maloku:**

Aktualisht është këshilltar komunal në Komunën e Junikut dhe, njëkohësisht, punon në Ministrinë e Transportit, në pozitën e udhëheqësit të sektorit të komunikacionit rrugor, ligjërues për Odën Ekonomike të Kosovës dhe ekspert i aksidenteve pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë. Gjatë periudhës së luftës, Maloku, sikurse dhe shumë të tjerë, ka ndjerë obligim që t’iu bashkohet radhëve të UÇK-së. Nga fusha profesionale, me interes të veçantë janë ngritja e aspekteve profesionale në fushën e komunikacionit, kontributi në fushën e zhvillimit ekonomik të vendit, në fushën e transportit rrugor dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, në fushat përkatëse si një ndër nyjat me të rëndësishme të zhvillimit të mëtejme të vendit.

Fushë me interes të veçantë nga AQL është ngritja e kapaciteteve qeverisëse dhe administrative të pushtetit lokal, dhe koordinimi me nivelin qendror, si dy shtylla të rëndësishme për jetën e qytetarit dhe për zhvillimin e vendit.

Nga AQL pret që të trajtohen temat e bashkëpunimit ndër-komunal, si çështje me rëndësi të veçantë në aspektin e ngritjes së kapaciteteve, harmonizimit dhe koordinimit të punëve në problemet që janë të përbashkëta. I rëndësishëm është edhe bashkëpunimi pozitë-opozitë në kuvendet komunale dhe ngritja e nivelit të debatit, përgjegjësisë dhe fuqizimi i demokracisë si nevojë që del përpara integritimeve rajonale dhe më gjerë.

**Besim Halili:**

Aktualisht shërben si profesor i Historisë në gjimnazin “Kuvendi i Lezhës”, në Viti. Është këshilltar i Kuvendit Komunal në Viti. Ka përfunduar Fakultetin e Historisë. Përvoja e tij profesionale ka dy dimensione, atë të profesorit dhe pedagogut dhe atë të përfaqësuesit politik të qytetarëve të Vitisë. Ai, edhe tani punon si profesor i Historisë dhe ka mandatin e dytë politik në Asamblenë Komunale. Me rastin e hartimit të kurikulit të arsimit nga MASHT, ka punuar në cilësinë e ekspertit. Avancimi profesional është synim i mëtejme dhe lidhet me atë shkencor si dhe vazhdimin e karrierës politike.

Besimi vlerëson se mësimet e nxjerra nga AQL do t’i shërbejnë si ogur i mirë në ngritjen profesionale të trajtimit të temave politike, me theks të veçantë të atyre që kanë të bëjnë me zhvillimet në qeverisjen lokale. Me interes të veçantë për t’u trajtuar gjatë sesioneve të ardhshme të AQL-së janë temat që kanë të bëjnë me efikasitetin e ekzekutivit komunal, shërbimeve kualitative për qytetarët, menaxhimi i financave, dhe hartimi i prioriteteve investive. Këto tema kanë rol kyç në zhvillimin sektorial, që drejtpërsëdrejti ndikon në jetën e qytetareve.

### **Srdan Todorović**

Aktualisht mban pozitën e Zëvendës kryesuesit të Komunës së Novobërdës. Ka një përvojë në drejtim të mirë në këtë detyrë. Synimet e tij kryesisht, lidhen me avancimin e karrierës profesionale.

Nga AQL me prioritet janë mësimet e nxjerra nga fusha e administratës, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve, menaxhimin e burimeve profesionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, për komunën e Novobërdës duke përfshi aspektin politik, si edhe atë të ndërtimit institucional. Komunitat shumëtnike, përpos dallimeve në dimension administrativ, kanë edhe veçori në aspekt të profilit të stafit dhe bashkëpunimit në ofrimin e shërbimeve të gjithë qytetarëve.

Përvojat e marra nga AQL do të shërbejnë në disa drejtime, duke përfshirë atë të lidhshimit komunal e, po ashtu, edhe në aspektin menaxherial. Ngritja e kapaciteteve komunale ka një rëndësi të veçantë. Mbetet të shpresohet që në bazë të përvojës që kemi fituar, do të bëjmë ndryshime thelbësore, që lidhen drejtpërdrejt në efikasitet e punës në komunë.

### **Goran Maksimović**

Aktualisht është i angazhuar në pozitën drejtor i Administratës në Komunën e Novobërdës. Një objektiv i rëndësishëm në aspektin profesional është përfitimi i përvojave të reja lidhur me punën dhe modelet që shërbejnë në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe administratës.

AQL me modulet e saja ka trajtuar temat në rrjedhë dhe sinkroni, e që si rezultat na ka ndihmuar që të kuptojmë rolin që kemi përballë qytetarëve dhe raportin që kemi me institucionet tjera.

Maksimović përshëndet AQL që ka trajtuar aspekte specifike, që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të shërbimit e, posaçërisht, të mësimin në lidhje me krijimin e një administrate të reformuar dhe efikase. Me pak fjalë, shkëmbimi i përvojave profesionale dhe atyre akademike, paraqet një ndihmesë të madhe për punën e secilit zyrtar komunal.

### **Vanja Trajković**

Është drejtoresh e administratës në Komunën e Ranillugut. Fushë me interes profesional për të është Menaxhimi i administratës.

Nga AQL pret thellimin e përvojës në lidhje me atë se cili duhet të jetë relacioni në mes të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes lokale, njohje më të mirë të reformimit të administratës publike, si të arrijmë që të kemi një shërbim civil të paanshëm, profesional, të përgjegjshëm.

Përshtypja e saj e deritashme është që ligjëratat dhe prezantimet nga profesorë dhe ekspertë të vendeve perëndimore ishin të dobishme nga se ka pas një këndvështrim më të avancuar dhe krahasues në lidhje me gjendjen e qeverisjes lokale në Kosovë. Tema me interes të veçantë për të ishte eksperienca e qeverisjes lokale dhe efikase nga vendet e rajonit, komunikimi efikas në mes të qeverisjes qendrore dhe asaj lokale.

**Violeta Tomić**

Aktualisht është këshilltare komunale në Komunën e Ranillugut. Gjatë kohës së organizimit të moduleve të deritanishme, Tomić shprehet se është shumë e kënaqur me informacionin dhe ligjëratat e ofruara nga AQL.

Me interes të veçantë është çështja e menaxhimit dhe aspektet që kanë dalë si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur në sistemin e qeverisjes lokale. Për Tomić është e rëndësishme të arrijë njohuri të reja në fushën e menaxhimit dhe, veçanërisht, ofrimin në shfrytëzim të pronave publike, me qëllim mundësimin e zhvillimit lokal në komunën ku ajo punon. Iniciativat atraktive në praktikat rajonale dhe më gjerë, janë të rëndësishme, ndërsa, në lidhje me këtë, Tomić propozon që AQL të organizojë sa më shumë vizita njohëse dhe studimore.

**Ana Nasković**

Aktualisht është Këshilltare në Kuvendin Komunal të Ranillugut. AQL duhet të vazhdojë të shërbejë në qartësimin e vizionit të trajnuarve, në mënyrë që ata t'ju shërbejnë qëllimeve që përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve. Fushat me interes të veçantë dhe pritjet specifike të Nasković nga AQL, kryesisht lidhen me fushën e ngritjes së kapaciteteve të administratës, reformën dhe ofrimin e shërbimeve cilësore qytetarëve.

Ana shprehet se është tërësisht e përkushtuar në misionin që i ka caktuar vetes dhe se bashkëpunimi dhe bashkërendimi i agjendave që ndihmon në përmirësimin e jetës së qytetarëve, për të janë shumë të rëndësishme. AQL, në të ardhmen, pret t'i shërbejë në aspektin e planifikimit të politikave dhe zbatimit të tyre me qasje sa më pragmatike dhe arritja e objektivave në mënyrë sa më efektive.

**Živko Tomić**

Aktualisht është këshilltar komunal në Komunën e Ranillugut. Interes i tij është fusha e zhvillimit ekonomik të vendit, fusha e komunikimit si fusha përkatëse të një rëndësie të veçantë të zhvillimit të mëtejshëm të vendit.

Fushë me interes të veçantë nga AQL është ngritja e kapaciteteve qeverisëse dhe administrative të pushtetit lokal, dhe koordinimi me nivelin qendror, si dy shtylla të rëndësishme për jetën e qytetarit dhe për zhvillimin e vendit.

Nga AQL pret që të trajtohen temat e bashkëpunimit ndër-komunal, si çështje me rëndësi të veçantë në aspektin e ngritjes së kapaciteteve, harmonizimit dhe koordinimit të punëve në problemet që janë të përbashkëta.

## HISTORIKU I REFORMËS SË QEVERISJES LOKALE DHE DECENTRALIZIMIT NË KOSOVË

### Moduli/Tema:

- Prezantimi i Programit Akademia e Qeverisjes Lokale;
- Historiku i Reformës së Qeverisjes Lokale dhe Decentralizimit në Kosovë;
- Formësimi i decentralizimit, aranzhimet dhe synimet ndërkombëtare përmes Dokumentit të Ahtisarit;
- Prezantimi i raportit (2009-2011) rreth progresit dhe sfidave të decentralizimit në vend.

### Ligjërues:

- **Besnik Tahiri**, drejtor Ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale;
- **Fatmir Haxholli**, Menaxher i Programeve Hulumtuese pranë KLGJ dhe ligjërues në Fakultetin e Gjilanit;
- **Lutfi Haziri**, ish-minister i Pushtetit Lokal dhe ish-kryetar i parë i Asociacionit të Komunave të Kosovës;
- **Steven Schook**, ish Zv/Shef i UMNIK-ut;
- **Adrian Zeqiri**, drejtor i Qendrës Evropiane për Çështje të Pakicave.

**Data:** 18 nëntor 2011;

**Vendi:** Hotel Sirius, Prishtinë;

Prezantimi në vija të trasha i programit “Akademia për Qeverisje Lokale” dhe agjendës së modulit (I), nga drejtori Ekzekutiv i KLGJ-së, Besnik Tahiri.

### Drejtori i KLGJ-së, Besnik Tahiri:

Kolikula do të jetë serioze, kualitative dhe do t’i përmbushë pritjet.

Grupi është mjaft divers në kuptimin e:

1. përvojës;
2. detyrave (funksioneve);
3. dhe kemi bashkëdyzim në mes të përvojës dhe funksioneve.

Elementet që janë në program:

Fuqizimi i legjislacionit dhe vendimmarrjes, programeve inventive.

Ndërkaq, asamblatë komunale janë të pafuqishme në raport me punët dhe me përgjegjësitë që kanë nga mandati që buron nga vota. Në program do të kemi ligjërues me renome dhe me përvoja nga fushat përkatëse nga universitete prestigjioze, Universiteti i Birminghamit, Universiteti i Eënes, ICDT. Të gjithë këta ligjërues me përvojë dhe influencë, do t’i sjellim me përkrahjen e B.C, FES, Ambasadës Norvegjeze në Republikën e Kosovës. Programi mëton që përmes kësaj të mësojmë nga përvoja dhe eksperiencia dhe, gjithashtu, drejtpërsëdrejti në investojmë në liderë lokalë potencialë. Shembull: Deri sa flasim për decentralizimin fiskal, ndërkaq komunat s’kanë mjete, kjo e bënë të vështirë punën në komuna, andaj ne, së bashku,

këtu do të flasim për problemet dhe modelet për qeverisje lokale efektive. Po ashtu, gjatë akademisë, përpos temave të gjera, do të merremi edhe me specifika të caktuara, si paraqitja publike, modelet për shkrimin e letrave zyrtare etj.

## **Historiku i Qeverisjes Lokale dhe Decentralizimi në Kosovë - mundësitë dhe sfidat. Ish-ministri i MAPL, z. Lutfi Haziri**

### **Ish-ministri i MAPL, z. Lutfi Haziri:**

Komunat e Kosovës, duke përmendur historinë e re, kanë filluar punën pas luftës çlirimtare nga Qeveria e Përkohshme, që buron nga Marrëveshja e Rambujesë. Nga këtu ka filluar organizimi i parë institucional në vend. Po në këtë kohë Malisheva dhe Deçani janë themeluar si komuna dhe më pas janë miratuar përmes rregullores së UNMIK-ut. Më pastaj, me zgjedhjet e para lokale është bërë themelimi dhe emërimi i institucioneve zyrtare, duke filluar dhe tranzicioni. Reforma institucionale në Kosovë merr projeksion dyshkallësh, ndërkaq të tjerat janë trupa ndihmëse, ngase nuk i nënshtrohen procesit zgjedhor. Ndërkaq, në vitin 2004 ka filluar një tjetër reformë që, më pastaj, është përcjellë edhe me decentralizimin, që ka nisur pas marrëveshjes së famshme Hakerup-Çoviç. Po ashtu, më pas, modeli që është përdorur deri atëherë, pra ai norvegjez (skandinav), ka ardhur si nevojë që të ndryshohet, si model në raport me administratën, që ka qenë i mirë, ngase ka promovuar profesionalizmin dhe meritokracinë, por ka ndodhur e kundërta kur politika ka ndërhyrë në rekrutimin e stafit. Si shembull të mirë mund ta marrim Komunën e Shtimes, që asnjëherë s'ka ndërhyrë në administratë, pavarësisht partisë që ka qeverisur.

Për ta fuqizuar rolin e komunave, së bashku me disa kryetarë të tjerë të komunave, në vitin 2001 kemi themeluar Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), si nevojë për të qëndruar karshi Qeverisë dhe UNMIK-ut (si qeveri në hije), në pjesëmarrje gjithëpartiake. Problemet që gjithmonë i kanë përcjellë komunat, kanë qenë në këto aspekte:

1. Aspektin financiar;
2. Aspektin përfaqësues;
3. Aspektin vendimmarres.

Nevoja për organizim të komunave ka qenë në aspektin e ndarjes midis komunave:

1. Komuna urbane
2. Komuna rurale.

Duke e bërë kështu dekoncentrimin dhe, më pas, decentralizimin dhe ngritjen e kapaciteteve. Në vitin 2004 është themeluar MAPL, si raport i nevojës për ndërtimin e konsensusit për reformën e pushtetit lokal. Kjo ministri është themeluar me dy parime:

1. Me qenë e vogël dhe e përgatitur dhe
2. Me pasë parasysh që do të përfundojë në momentin kur të mbyllet procesi.

Dokumenti i parë ka qenë në aspektin e rregullimit urban dhe rural, ndërkaq një pjesë e stafit është bartur nga ministritë tjera. Kryeministri Haradinaj ka qenë ithtar i bartjes

së kompetencave, në bazë të modelit francez. Në vitin 2005 ka dalë propozimi për pesë (5) pilot-komuna, prej të cilave dy refuzuan. Ndërkaq, si shembull i suksesit të pilot-njësive është Mamusha. Kjo komunë është transformuar nga një komunë bujqësore në komunë në zhvillim. Negociatat e Vjenës kanë mbyllur procesin e themelimit të komunave dhe kjo erdhi jo si kërkesë e institucioneve, por si platformë ndërkombëtare. Serbët në këto negociata janë përfaqësuar si delegacion nga Beogradi dhe kanë ardhur me kërkesën për formimin e 24 komunave të etnisë serbe, ndërkaq me themelimin e 5 komunave, kusht për themelimin e tyre ka qenë numri prej 5000 banorësh.

E tërë kjo duhet të rishikohet në vitin 2013, në raport me atë se si ka ecur procesi i decentralizimit të komunave dhe nevojave për rishikim, në raport me sigurinë lidhur me rolin e EULEX-i, se sa po i përmbushë detyrimet që ka.

- **Sfidat që i dalin përpara MAPL-së:**
  1. **Delegimi në monitorimin e komunave,**
  2. **Aspektii i shpërndarjes financiare,**
  3. **Rishikimi funksional.**

Ministri Petkoviç është treguar bashkëpunues, në raport me komunat, sidomos në menaxhimin e financave. Reforma, nëse vazhdon gjatë, do të ketë presion edhe më të madh për bartje të kompetencave. Ju lus edhe për zbatim të ligjeve. Kryetari i komunës është i zgjedhur drejtpërdrejt, por nuk është mbi kuvendet komunale. Edhe pse kjo është e rregulluar me ligj, në mase të madhe po ndodhë e kundërta. Sistemi skandinav, por dhe ky gjermano-francez, është treguar i pasuksesshëm, dhe shtrohet nevoja për ndryshime. Për fund, zbatoni kompetencat, sepse në të kundërtën, rrezikoni t'i humbasni.

#### **Drejtori i KLGJ-së, Besnik Tahiri:**

Gjatë vizitave nëpër komuna shoh përmirësim në konsolidimin e demokracisë, por tri çështje janë me rëndësi të veçantë :

1. A po zbatohen kompetencat?
2. A jemi në shërbim të qytetarëve?
3. Si po i menaxhojmë financat?

**Formësimi i Decentralizimit – aranzhmanet dhe synimet ndërkombëtare përmes Dokumentit të Ahtisarit.**

**Prezantimi i raportit (2009-2011) rreth progresit dhe sfidave të decentralizimit në vend.**

#### **Përfundimi.**

**Drejtori i KLGJ-se Besnik Tahiri:** Prezantimi i hulumtimeve të KLGJ-së, “ E qartë në letër – e dobët në terren” dhe “Decentralizimi peshë e rëndë për t’u bartur”. Në to paraqiten qartë mangësitë dhe nevojat e komunave, si në rastin e Komunës së Hanit Elezit, ku roja e komunës është i obliguar ta ruajë dhe Qendrën për Pune Sociale, pasi që MPMS, me rastin e bartjes së kompetencave, i ka ndërprerë pagesat për shumë segmente. Kurse, në Novobërdë është bërë bartja e përgjegjësisë në mbrojtjen e pyjeve, ndërkaq lejen për shfrytëzim e japin autoritetet qendrore.

## MARRDHËNIET NË MES TË TË ZGJEDHURVE POLITIKË (KRYETARIT) DHE SHËRBYESVE CIVILË (ADMINISTRATËS KOMUNALE)

### Moduli/Tema:

- Marrëdhëniet në mes të të zgjedhurve politikë (Kryetarit) dhe shërbyesve civilë (administratës komunale);
- Konceptet akademike në lidhje me marrëdhëniet në mes të nivelit politik dhe shërbyesve civilë. Rasti i Mbretërisë së Bashkuar;
- Procesi i reformës në administratën shtetërore në vend.

### Ligjërues:

- **Prof. Dr. Ita O'Donovan**, ligjëruese në Universitetin e Birmingham-it dhe, njëkohësisht, eksperte e Komisionit Evropian;
- **Agron Maxhuni**, Drejtor i Departamentit Ligjor pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal ;
- **Besnik Tahiri**, Drejtor ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale.

**Data:** 8 dhjetor 2011

**Vendi:** Hotel Sirius, Prishtinë.

Synimi i këtij moduli është të shtjellojë marrëdhëniet në mes të të zgjedhurve politikë (Kryetarit) dhe shërbyesve civilë (administratës komunale). Për këtë qëllim KLGI ka trajtuar shembullin anglez, duke ftuar Prof. Dr. Ita O'Donovan, ligjëruese në Universitetin e Birminghamit dhe, njëherësh, eksperte e Komisionit Evropian.

Në këtë modul u trajtuan dhe diskutuan shembuj të ndryshëm edhe nga Kosova dhe, në këtë kontekst, prezantimet e tyre i paraqitën Agron Maxhuni, drejtor i Departamentit Ligjor, pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Besnik Tahiri, drejtor Ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale.

Znj. O'Donovan filloi shtjellimin e temës, duke ofruar shembujt nga vendi i saj dhe nga përvoja personale. Ajo tregoi se zyrtarët e qeverisë lokale në Angli janë të gatshëm të punojnë me të gjitha partitë, qofshin liberale apo konservative. Buxheti komunal i kushtoi theks të veçantë, duke thënë se resurset buxhetore sqarohen se me çfarë komune kemi të bëjmë, por, pavarësisht buxhetit të pamjaftueshëm, komunat duhet t'iu përshtaten kërkesave të qytetarëve.

Duke bërë sqarimin në dallimin në mes të përbërjes politike dhe stafit civil, ligjëruesja theksoi se koncepti i qytetarit është shumë i rëndësishëm në Mbretërinë e Bashkuar, ngase të gjithë qytetarët i paguajnë taksat vetëm nga të ardhurat 22 %, dhe të tjerat 15 %, që në teresi i bie afër 40%. Po ashtu, edhe mediat janë shumë të fuqishme dhe këto dy komponenta, së bashku, bëjnë presion të vazhdueshëm për cilësi të shërbimeve dhe të politikave. Në takimet e kuvendeve komunale ekziston gjithmonë një numër i madh qytetarësh, që monitorojnë mbledhjet dhe kjo sjellë qytetari aktive në politikë. Çështjet për të cilat qytetarët në Angli interesohen, janë kryesisht për:

- Kualitetin e ujit;
- Mbrojtjen e ambientit;
- Mbrojtjen e të rinjve;
- Shëndetësi, shkolla etj.

Qeveria në Mbretërinë e Bashkuar u ka dhënë autonomi shumë të madhe komunave. Por, para së gjithash, kushtetutat (statutet) e tyre i kanë shkruar vetë me ekipe ekspertësh që i kanë përshtatur dhe dizajnuar në nivel lokal. Profili komunal nuk është i dominuar nga meshkujt, por ka një balanc në përfaqësimin gjinor. Kryetari, sikurse në Kosovë, ua ndanë protofolion drejtorëve. Asambleja e mban në llogaridhënie ekzekutivin dhe kështu kemi balanc, të gjithë e kanë të qartë se janë nën mbikëqyrje.

Lidershipi i komunitetit, kryetarët, janë me rëndësi, por duhet të jene gjithmonë në raport me interesat e qytetarëve, shpjegoi ndër të tjera znj. O’Odonovan. Ajo tha se dekoncentrimi është domosdoshmëri, për arsye të arritjes së objektivave, sepse vetëm kështu do të përfaqësojnë. Lidershipi i komunitetit nënkupton ndarjen e pushtetit. Në rastet kur kërkohet 50+1, dhe kjo ndodh shpesh të mos i kemi votat e mjaftueshme, atëherë kemi debate që zgjasin. Profesionistet dhe shërbyesit civilë kanë rol të rëndësishëm në këtë proces, si në rastin e buxhetit zyrtarët financiarë (drejtori i financave) dhe i thesarit. Znj. O’Odonovan mori shembull rastin, kur një ministër (Lion Fox) i cili i kishte marginalizuar shërbyesit civilë, ngase ai ishte mësuar në menaxhimin e biznesit privat, dhe ka menduar se di më mirë se profesionistet, por ka qeverisur vetëm tri ditë; ka qenë politikan i përkushtuar, por nuk iu është përshtatur rregulloreve. Sipas saj, fuqia qëndron në të dy anët, në shërbyesit civilë dhe në politikanë.



Por Znj. O’Odonovan theksoi se as në Mbretërinë e Bashkuar sistemi nuk është i përkryer. Zonja O’Odonovan tregoi se ajo çfarë ndodh në fillim të administratës është që të gjithë punojnë me zell, që të tregojnë që e kuptojnë qartë drejtimin politik. Por, theksoi se politika duhet të zbatohet në të gjitha rastet në përputhje me ligjin. Në vazhdimësi kemi nevojë të shkëmbejmë përvoja në mes të politikaneve dhe të zyrtarëve. Në komuna që nuk ka besim, nuk mund të ketë zhvillim, përfundoi ajo.

Në anën tjetër, lidhur me procesin e reformës në administratën shtetërore në Kosovë, z. Agron Maxhuni, drejtor i Departamentit Ligjor pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal, prezantoi rrjedhën e vetëqeverisjes lokale, duke filluar me administratën e UNMIK-ut, rregulloren për vetëqeverisjen lokale, pengesat dhe rregulloret plotësuese. Sipas tij, në vitin 2005 komunat kanë ardhur në një fazë kur është dashur të fillojnë nga e para, për shkak të ndryshimeve politike të derivuara nga Plani i presidentit Ahtisari, i cili ka futur në kushtetutë parimet e qeverisjes lokale:

- Kushtetuta e Kosovës
- Karta Evropiane
- Ligjet tjera.

Sipas z. Maxhuni, legjislacioni i ri ka nxjerrë dy organe komunale: Kryetarin e Komunes dhe Kuvendin Komunal. Roli i asambleve, që nga viti 2000-2009, ka rënë vazhdimisht dhe në këtë rast ka ndikuar drejtpërdrejt sistemi zgjedhor. Kjo ka krijuar delegatë të kontrolluar nga degët. Parimi i decentralizimit e ka të lidhur ngusht subsidiaritetin. Shumica e komunave të Kosovës ushtrojnë kompetenca të njëjta.



Raporti në mes të Kryetarit dhe Kuvendit duhet të jetë bashkëpunues. Komitetet sektoriale duhet të marrin njerëz profesionalë për forcimin e politikave. Z. Maxhuni theksoi se se gjatë hartimit të ligjit për qeverisjen lokale ka shprehur mendimin që drejtorët e drejtorateve duhet të jenë shërbyes civilë, por ka ndodhur e kundërta, kur tani kemi njerëz që shumicën e kohës e harxhojnë në angazhime politike, sidomos në kohën e fushatave komunale mbasin të zbratura. Sipas tij, sistemi tek ne ka sfida dhe moskoordinim në mes të kuvendeve komunale dhe kryetarit. Është mirë që shefi i personelit ka lidhje direkte me kryetarin e komunës, por në këtë rast administrata e komunës nuk e ka rolin e vitit 2008.

Parimet kryesore të qeverisjes lokale:

- Parimi i ligjshmërisë
- Efikasiteti
- Efektiviteti.

Gjatë diskutimeve u potencua se Raporti i Progresit i Komisionit Evropian nxjerrë në pah se:

- Kuvendet komunale dhe kryetari kanë raporte ad-hoc;
- Mungon harmonizimi në mes të politikave lokale dhe atyre qendrore.

Legjislacioni për shërbimin civil bazohet në sistemin gjerman të qeverisjes. Kemi shërbyes civilë të karrierës dhe jo të karrierës. Në rast të zgjedhjes politike, mandati civil pezullohet dhe zëvendësohet me një zyrtar jo të karrierës. Një shërbyes civil i karrierës e fiton këtë pas dy vitesh vlerësimi. Në partneritet me donatorët janë caktuar kufizimet e stafit dhe janë bazuar në kriteret:

- Kriteret bazike;
- Kriteret suplementare;
- Kriteret në bazë të nxënësve;
- Tanimë edhe për çështje sociale.

Konflikti i interesit vjen në këto raste :

- Në mes të shërbyesve civilë dhe përfaqësimit politik;
- Në kuvendet komunale;

Bashkëpunimi ndërkomunal ndikon në ofrimin e shërbimeve dhe bashkimit të resurseve.

Mangësitë e pushtetit lokal:

- Vullneti Politik;
- Mungesa e planifikimit strategjik afatgjatë;
- Mosharmonizimi ligjor;
- Ligji për ndërmarrjet publike;
- Bashkëpunimi më i qëndrueshëm i ndërmarrjeve publike me komunat.

Z. Besnik Tahiri, në fjalimin e tij theksoi se sa i përket qeverisjes lokale, Kosova është në rregull në letër, por kur zbrësim në praktikë, ndeshemi në shumë probleme. Kryetari të komunës i kemi dhënë fuqi nënshtruese, asamblatë komunale s'po mund ta kenë nën kontroll ose ta monitorojnë, ka mungesa të zyrave për kryesues të kuvendit komunal dhe për grupe parlamentare. Opozita gjendet e ngulfatur, sepse të gjitha interesat e qytetareve sillen rreth kryetarit dhe ekzekutivit. Sipas z. Tahiri,

sistemi është duke rënë, kryetari ka fuqi politike, por jo dhe praktike. Asnjë nga komunat s'po arrinë t'i menaxhojë kompetencat e bartura. Niveli i reformës së pushtetit lokal ka nevojë të determinojë kërkesën e kërkesa ofertën, por kemi sistem të imponuar për arsye politike.

Z. Tahiri, ndër të tjera, theksoi se sistemi në qeverisje lokale do të bjerë, nëse nuk i bëjmë reformat e duhura. Sipas tij, ligji për shërbyesit civilë nuk ka të bëjë me meritokracinë. Sipas tij, është crucial rishikimi i qeverisjes lokale.

## RELACIONET NDËRMJET NIVELIT QENDROR (QEVERISË) DHE ATIJ LOKAL (KOMUNËS)

### Moduli/Tema:

- Marrëdhëniet midis institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal.  
Funksionimi i tanishëm i sistemit të komunikimit në mes të nivelit qendror dhe atij lokal: Aktet komunale: Prezantimi i Raportit të OSBE-së rreth kësaj teme;
- Reforma e administratës publike në nivelin qendror-ndikimi në marrëdhëniet në mes të qeverisë dhe të komunës;
- Planet e Akademisë për Qeverisjen Lokale për vitin 2012.

### Ligjërues:

- **Besnik Osmani**, Sekretar i Përhershëm i Ministrisë së Pushtetit Lokal;
- **Znj. Nensi Jasharaj**, Këshilltare Ligjore pranë Misionit të OSBE-së;
- **Bardha Hamza**, drejtoreshë për Reformën e Administratës Publike;
- **Besnik Tahiri**, drejtor Ekzekutiv i KLGJ-së.
- 

**Datë: 19 janar 2012;**

**Vendi:** Qendra e Konferencave Sirius.

Përshkrimi i modulit. Synimi i këtij moduli është që të tregojë marrëdhëniet nëpërmjet nivelit qendror (Qeverisë) dhe atij lokal (Komunës). Për këtë arsye, KGLI e ka ftuar z. Besnik Osmani, Sekretar i Përhershëm i Ministrisë së Pushtetit Lokal, gjithashtu një ndër themeluesit e kësaj ministrie, për të prezantuar në lidhje me temën. Në këtë modul u trajtua, gjithashtu, tema e qeverisjes lokale dhe prezantimi i raportit të OSBE-së nga Znj. Nensi Jasharaj, Këshilltare Ligjore pranë Misionit të OSBE-së. Gjithashtu, u diskutua në lidhje me reformën e administratës, marrëdhëniet financiare të prezantuara nga Znj. Bardha Hamza, drejtoreshë për Reformën në Administratën Publike.

Z. Besnik Osmani, Sekretar i Përhershëm i Ministrisë së Pushtetit Lokal, tha se ka perfunduar një plan strategjik për 2012, dhe u shpreh se ky vit do të jetë i rëndësishëm sikurse viti 2005, sepse këtu ka filluar decentralizimi, ndërsa në këtë vit do ta shqyrtojnë procesin e, në veçanti, tri çështje ligjore:

1. Ligjet për ndërmarrjet publike;
2. Ligjin për ndërtimin;
3. Kompetencat (qartësimi i tyre).

Përsa i përket çështjes së themelimit të Komunës së Mitrovicës, ai u shpreh se ishte duke i bërë konsultimet e fundit për kohën 6-mujore. Z. Osmani foli për perceptimin e qeverisjes lokale dhe qendrore, për raportet që lidhen me financat. Ai tha se kanë punuar e dhe planin që ka dalë nga Raporti i Progresit. Sipas tij, nga viti 2008 ka një progres në relacionet qeveri-komuna, por s'kanë bërë shumë sipas raporteve të huaja. Shfaqen tri probleme kryesore: e para ka të bëjë me çështjen e raportimeve, ka kryetarë që dorëzojnë raporte dhe aso që i bojkotojnë. Problemi kyç mbetet natyra e vendimeve të rënda, lidhjet me tokat dhe pronën. Problemi i dytë është partneriteti

publiko-privat. Problemi i tretë është fillestar dhe është tek huatë. Ndërsa, në çështjen e administratës është bërë përparim dhe së shpejti do të ketë qasje online.

Z. Osmani tha se kanë shpenzuar buxhet, por edhe kanë arritur sukses në këtë çështje dhe se problemi që iu del këtu është përdorimi i këtyre sistemeve dhe mungesa e ekspertëve. Progresi në këto fusha është i madh. Në fund u ndal për të shpjeguar se kishin marrë një vërejtje se MAPL ka bërë progres në raportet qeveri-komunë, por nuk e kanë dërguar asnjë komunë në gjykatë.

Ai tha se në gjykatë dërgojnë raste të shkeljes së ligjshmërisë. Kjo ndodhë, në bazë të raporteve për komunitat, për çështjen e ligjshmërisë dhe raportit për performancën. Problem më të madh e kanë ndarjen e kompetencave të përziera. Në raportin e dëmeve të fatkeqësisë tani nga erërat ka tendenca të bartjes se fajit në rastin e shkollave, Ministria e Arsimit thotë se shkollat janë të pavarura, në atë se ku fillon dhe kur përfundon vija e kontrollit dhe bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe të komunave.

USAID-i e ka bartur përgjegjësinë për shpenzimin e fondeve që na ndahen.

Nga ana tjetër, lidhur me marrëdhëniet midis institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, u prezantua raporti i OSBE-se nga znj. Nensi Jasharaj. Ajo tha se ky raport ka të bëjë me shqyrtimin e raporteve në mes të komunave dhe nivelit qendror, të bashkëpunimit dhe të funksionimit të kuvendeve komunale. Një nga mënyrat për t'u bërë është mbikëqyrja administrative. Ajo shtoi se vlerësimi që bën MAPL është më tepër opinion.

Z. Jasharaj tha se ky raport është bërë në monitorimin e 34 komunave, me intervista në strukturat komunale dhe MAPL-së.

Të gjeturat kryesore ishin: Përpjekja e vazhdueshme e dy niveleve si në fazën e para-adoptimit dhe atë të adoptimit. Sipas Nenit 83, kërkesa bëhet për një akt se a është në përputhje me ligjin, kjo mundësi në vitin 2009 s'ka qenë e stilizuar, por tani është duke u praktikuar. Sipas raportit, ka ndodhur krijimi i mekanizmave që ndikojnë në komunikim (komunikimi ndërministror, zyrtarët kontaktues komunalë) në shumicën e rasteve është drejtori i Administratës. Por, ajo theksoi se përfaqësuesit e nivelit qendror duhet të jenë prezentë në mbledhjet e kuvendeve komunale. Zyrtarët ligjorë kanë qenë pak të involvuar dhe shihet si mangësi. Në vitin 2009 zyrtarët ligjorë kanë qenë të shpërndarë dhe ka dalë si mënyrë krijimi i zyrës së veçantë. Përderisa ekziston një pasqyrë komunave, se aktet dërgohen në ministri, lista e zyrtarëve që janë përgjegjës, e që janë të obliguar, është shumë e gjerë dhe ka harmoni. Gjithashtu, ajo tha se roli i zyrtarëve komunalë në procesin e shqyrtimit administrativ, nuk është definuar. Mungesa e jurispondencës lidhur me aktet komunale kontestuese. Sipas analizës është dashur, në rast të veçantë, ta zgjidhë gjykata.

Në fund, z. Jasharaj dha disa rekomandime, të cilat kishin të bënin me vazhdimin e konsultimit paraprak dhe informatave për nivelin qendror, me aktivitetin e komunave në çështjet legjislativë. Niveli qendror duhet të vazhdojë monitorimin e mbledhjeve të kuvendeve komunale. Ajo tha se është praktikë që klauzola të vlerësohet në heshtje, gjithashtu duhet të sfidohen rastet në gjykata, si edhe të përmirësohet niveli i performancës ndërministrorë, varësisht prej fushës së veprimit të akteve.

Lidhur me reformat në administratën publike në nivelin qendror dhe marrëdhëniet mes qeverisë dhe komunës, prezantoi znj. Bardha Rrustemi. Ajo reflektoi në 2-3 pista

dhe filloi me atë që e quajmë parlament, njerëz të zgjedhur nga të gjithë qytetarët e vendit. Znj. Rustemi tha se është i domosdoshem kontrolli i lartë dhe shpërndarja. Ajo theksoi se kur jemi te pagat dhe mëditjet, që janë të monitoruara nga FMN-ja, jemi të obliguar t'i zbatojmë dhe se nocionet e politikave publike kryesisht zbërthehen në ligje dhe strategji.

Z. Besnik Tahiri, në fjalimin e tij, tha se vetëm tek shërbimet civile kemi të bëjmë me një gamë të madhe ligjesh dhe dokumenteve strategjike, kur flasim për reformën që prekë vendet e punës. Sipas tij, kur flasim për administratën, flasim për njerëz, dhe nuk flasim thjesht për ligje. Nuk është e tepërt të thuhet se ne e kemi ndërtuar administratën prej fillimit dhe shërbimi civil është duke u bërë unik, konkludoi ai.

## MARRDHËNIET NË MES PARLAMENTIT DHE KOMUNAVE; DECENTALIZIMI - KONCEPT I RI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

### Moduli/Tema:

- Marrëdhëniet në mes të Parlamentit dhe Komunave
- Decentralizimi koncept i ri i ofrimit të shërbimeve
- Relacionet në mes të Parlamentit dhe Komunave në Republikën e Maqedonisë

### Ligjërues:

**z. Josip Juratoviç**, Parlamentar i Bundestagut Gjerman

**z. Riza Halimi**, Anëtar i Parlamentit të Serbisë dhe ish-kryetar komune

**z. Rizvan Sylejmani**, Ish Ministër i Pushtetit Lokal dhe Parlamentar në Kuvendin e Maqedonisë

**z. Besnik Tahiri**, Drejtor i KLLGI

**Data:** 23 shkurt, 2012

**Vendi:** Hotel Sirius, Prishtine

Qëllimi kryesor i këtij moduli është që të tregojë marrëdhëniet mes Parlamentit dhe Komunave. Për këtë arsye, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale ka ftuar z. Josip Juratovic, Parlamentar Gjerman i Bundestagut për të sjelle përvojat të qeverisjes Gjermane si në aspektin lokal ashtu dhe atë qendror.

Ne këtë modul u trajtuan gjithashtu modele të qeverisjes nga Serbia, Kosova dhe Republika e Maqedonisë ku të ftuar ishin personalitete me përvojë të madhe në qeverisje si z. Riza Halimi, anëtar i Parlamentit të Serbisë dhe ish-kryetar komune si dhe z. Rizvan Sylejmani, Ministër i Pushtetit Lokal dhe Parlamentar në Kuvendin e Maqedonisë.

Z. Josip Juratovic, Parlamentar i Bundestagut Gjerman filloi trajtimin e prezantimit të tij duke dhënë shembuj nga vendi i tij po ashtu edhe nga përvoja personale. Ai tregoi se në Gjermani problemi i parë është se niveli lokal është drejtpërdrejt me qytetarin por ata nuk kanë mjete, në Gjermani ka disa nivele qeverisëse dhe secili përgatit, nxjerr ligje dhe shpërndan buxhet. Ai shpjegoi se problemet kryesore në vend janë të mjetet financiare, se si shpenzohen ato. Gjithashtu theksoi se problem kyç në Gjermani është edhe nataliteti, permiresimi i gjendjes familjare

Sipas tij qëllimi kryesor është që të ofrohen shërbime më të mira dhe e rëndësishme është se si punohet në nivel lokal. Në kuvendin Gjerman u shpreh ai, secili është i angazhuar në fushat e caktuara por më së miri është të shikohet qeverisja dhe shërbimet që ofrohen. Nga ana tjetër lidhur me përvojat rajonale për qeverisjen lokale dhe aspektin e bashkëpunimit në kuvend prezantoi z. Riza Halimi, Anëtar i Parlamentit të Serbisë dhe ish-kryetar komune.

Z. Halimi shpjegoi se në Serbi ka probleme mes kuvendeve dhe kryetareve për shkak të bllokadave dhe se në rastin e tyre qytetari nuk ka asnjë rol në organet vendimmarrëse. Ai tha se deri tani në Serbi kanë pasur sistemin e qyteteve ndërsa me pas ka filluar rregullimi dhe i komunave në kuadër të qytetit. Në rast se kërkohet rajonalizimi i qeverisjes, në Serbi shihet si separatizem në veçanti të Vojvodina, dhe

marrin si model Kosovën. Ka gatishmëri të barten disa kompetenca por jo të njihen specifikat kulturore dhe etnike shpjego ai. Ai tha se pushtetet lokale ne Serbi nuk financohen dhe shtoj se ne Vojvodine ku ka financa u është dhene nje rol qeverises por sfide per Vojvodinen mbetet frika nga shkëputja. Theks te vecante vuri mbi shembullin e Kosoves dhe u shpreh se derisa te kete nje sistem gllomaz ne Serbi, ska per te pasur sherbime per qytetarin.

Persa iu perket përvojave, levizjeve dhe aktivitetetve ne Republikën e Maqedonisë i ftuar ishte **Z. Rizvan Sylejmani**, Ish-Ministër i Pushtetit Lokal dhe Parlamentar në Kuvendin e Maqedonisë. Ai tha se procesi i decentralizimit në Maqedoni kishte probleme politike dhe paraqitej si i politizuar, për me teper ishte nje proces i komplikuar dhe i nderlidhur me emocione kulturore dhe etnike. Ai u shpreh se ne Maqedoni pushteti qendrorë dhe ai lokal nuk kane interesa te perbashketa.

Sipas tij niveli i decentralizimit nuk matet me kompetenca por me atë sa janë bartur mjete dhe si ndahen. Gjithashtu ai permendi edhe nje rast ku komunat shqiptare ankohen per diskriminim nga poushteti qendror por qe kjo vjen edhe si pasoje e mungeses se bashkupunimit dhe vullnetit, perfundoi ai.

Z. Besnik Tahiri ne fjalim e tij permendi disa aspekte, si:

- Komunat e vogla për të krijuar të hyrat e tyre është e pa mundshme që nënkupton se komunat janë të varura nga niveli qendror.
- Diskriminimi pozitiv i komunave që e ka partia qeverisjes qendrore dhe e kundërta që ndodh me komunat tjera.
- Raporti në mes Kryetarit dhe Asamblesë në raportin e demokracisë kjo është e mirë por ne rastin tone sjell probleme.

Ai shpjegoi se Kosova ka dy nivele qeverisëse qendror dhe lokal. Ndarja në rajone e Kosovës është e vështire sepse kështu do të shëndërrohej në krahinizim përpos atij që ekziston partiak. Ai theksoj se element i rëndësishëm është se në qytetet e mëdha kanë konceptim te zhvillimit, atëherë çfare po ndodh me komunat e vogla eshte nje qeverisje e centralizuar ku vendimmarrja e qytetarit është proforme.

## MARRËDHËNIET NË MES TË MEDIAVE DHE KOMUNAVE

### Modulet/Temat:

- Transparenca ne komunikim
- Bazat ne marredhenie me publikun dhe komunikimin

### Ligjerues:

**Z.Besnik Tahiri**, drejtor ekzekutiv i KLGJ

**Z.Donat Syla**, kryeredaktor RTK

**Z.Bekim Salihu**, gazetar qe percjellë ngjarjet ne komunen e prishtines, Koha Ditore

**Date:** Febrary 24, 2012

**Venue:** Qendra e Konferencave Sirius

Ne vazhdimesine e modulit te trete u diskutuan ceshtje te rendesishme lidhur me marredheniet me publikun dhe transparencen ne komunikim te qeverisjes lokale. Per kete arsye, KLGJ kishte ftuar per te prezantuar lidhur me keto ceshtjet Z. Donat Syla kryeredaktor ne televizionin publik RTK si edhe Z. Besnik Salihu gazetar ne gazeten “Koha Ditore”.

Z. Donat Syla, ne fjalimin e tij u shpreh se komunikimi ndihmon në rritjen e performancës dhe se jeta mediale nuk është aq e zhvilluar aq më pak në ato lokale. Ai tha se gjate përvojës se tij s’ka ndodhur që njëra nga komunat të kërkoj të trajtoje një teme të caktuar. Duke ju referuar fatkeqësisë së Restelices, ai tha se gjatë gjithë kohës kishin komunikuar me qytetare por ka qenë i vështirë komunikimi me komunën. Ai shtoi se jeta politike brenda komunave është shumë me interes por tek ne transmetohet pak. Shkak i mungesës se komunikimit është një mangësi e këtyre komunave. Ka mungese informacioni nga zyret për marredhenie me publikun dhe vetëm njëra nga komunat dërgon informacionet e aktiviteteve. Për dallim, niveli qendror që është shumë me komunikues. Sipas tij ndodh shpesh qe zyrat e informacionit nuk e bëjnë kreativ lajmin. E gjithë kjo është çështje e ndërtimit te komunikimit me mediat.

Z.Syla tha se RTK ka korrespondente ne 3 komuna. Dhe këta korrespondent sjellin informacione. Ai theksoi se me interes per ta jane problemet reale e jo takimet e zakonshme protokollare. Ai u shpreh se brenda ditës arrijne te marrin 1000 e-maile por jo cdo informacion është me interes të publikut.

Gjithashtu ai tha se nuk eshte e mundur qe te përcillen te gjitha komunat dhe ngjarjet interesante per transmetim pasi ata jane vetem nje kanal dhe ka mungesë të kapaciteteve humane.

Z.Syla shprehu gatishmërine per te pasur takime të tjera per te biseduar mbi fushën e bashkëpunimit dhe komunikimit me komunat.

Z.Bekim Salihu, gazetar qe përcjell ngjarjet ne komunen e Prishtines nga “Koha Ditore”, ne prezantimin e tij tha se shpeshherë ndodh që gazetari të mos jetë profesionist. Sipas tij, rasti i komunes se Prishtinës në raportin e komunikimit me media është për çdo kritikë. “Çurcill ka thënë se mediat edhe gratë nuk duhen irrituar “. Ai tha se aspekti i komunikimit në mes zyrtarit dhe gazetarit është i ngarkuar. Sipas



tij, mediave në përgjithësi ju interesojnë lajmet që janë me interes për qytetarin. Ai theksoi se paraqitja e lajmeve duhet bazohet në eksperte dhe jo në qytetarë. Mediat përveç që e kanë rolin e informimit mund të shërbejnë dhe si këshilluese. Ka pasur raste kur mediat kanë shtyre anulimin e tenderëve. Pjesa dërmuese e informacioneve që vijnë në gazete nga komunat janë protokollare. Gazetari në shumicën e rasteve orienton çështjen. Gjithashtu ai tha se është e rëndësishme gjetja e një gjuhe bindese kur komunikoni me median, në mënyrë që të arrijmë të bindim atë për të paraqitur informacionin që dëshirojmë. Gjithashtu ai shtoi se jemi një shoqëri politike dhe se gradualisht po zhvendosemi të çështjet lokale që janë të rëndësishme dhe esenciale.

Z. Salihu tha se lajmi i keq është lajm i mirë për mediat. Mediat i kanë përcjell zhvillimet në komunat e mëdha. Mbledhjet komunale janë temat finale sepse ato vijnë nga ekzekutivi. Shpesh ndodh që mediat të jenë të pa sakta në informata. Gjithashtu ekziston edhe implikimi i miqësisë dhe ai financiar.

Z. Besnik Tahiri në fjalimin e tij tha se në jetën publike nuk është domethënëse puna pa prezantimin në publik. SHBA-të janë kampion në marrëdhënie me publikun, e kanë kthyer marketingun në shkencë. Kur janë përcaktuar parimet e qeverisjes së mirë në vitet e 90-ta pas nevojës së komunikimit atëherë parimi themelor ka qenë llogaridhënia dhe transparenca. Në strukturën e një medie gazetari është shumë i rëndësishëm. Sipas tij ndërtimi i marrëdhënieve duhet të jete në dy vija; në atë formal dhe informal. Ai tha se në kemi 36 komuna ku konkurrenca është me 3 minuta. Në fund Z. Tahiri paraqiti disa faza akademike që pasqyrojnë bazën e komunikimit.

## UDHËZIMET DHE KONSULTIMET ME GJASHTË KRYETARËT E KOMUNAVE

### TEMAT:

- Sfidat dhe Perspektivat e Sistemit të Qeverisjes Lokale dhe Decentralizimi në Kosovë- perspektiva komunale (Konsultime dhe Sqarime me të gjashtë Kryetaret e Komunave)
- Reformat në Qeverisjen Lokale, Sfidat dhe Progresi.
- Perspektiva e FES në Kosovë mbi Decentralizimin dhe Demokracia Lokale në Kosovë

### Ligjërues:

- Z. Besnik Tahiri, KLGJ, drejtor
- 

Prezantime të shkurtra nga kryetaret:

- **Z.Besim Halimi**, Viti/Vitina
- **Z.Gradimir Mikic**, Mayor of Ranillugë/Ranilug
- **Z.Bajrush Ymeri**, Mayor of Artanë/Novo Brdo
- **Z.Mehmet Krasniqi**, Mayor of Kastriot/Obilic
- **Z.Rufki Suma**, Mayor of Hani i Elezit
- **Z.Vllaznim Maloku**, Junik
- **Znj. Beate Martin**, FES Country Director
- **Wulf Lupins**, FES
- **Arjeta Emra**, British Council

**DATA: 5 MARS, 2012**

**VENDI : SIRIUS HOTEL, PRISHTINE**

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte konsultimi dhe sqarimi me të gjashtë kryetaret e komunave lidhur me sfidat dhe perspektivat e sistemit të qeverisjes lokale. Gjithashtu u diskutua dhe në lidhje me reformat që duhet të ndermeren në qeverisjen lokale si edhe perspektiva e FES-it në Kosovë mbi decentralizimin dhe demokracinë lokale në Kosovë.

Z.Besnik.Tahiri ky takim shërben si konsultim dhe do të trajtohen 3 tema; reforma e qeverisjes lokale, sfidat dhe progresi i arritur sipas studimit të bërë, si edhe procesi i evoluimit.

Bashkëbisedimi është i rëndësishëm për të marrë ide mbi procesin e decentralizimit. Z. Tahiri shtoi se tri komuna janë të prekura drejtpërdrejt nga procesi i decentralizimit dy komuna specifika në raport me komunat tjera duke përfshirë këtu Obiliqin dhe Junikun.

Ka pasur një proces dinamik të miratimit të ligjeve që dalin nga plani Ahtisari. Publikimin e 2010 i kanë quajtur “ E qartë në letër, turbullt në praktikë”.

Lidhur me sfidat edhe Perspektivat e sistemit të qeverisjes lokale si edhe decentralizimit në Kosovë prezantuan gjashtë Kryetaret e Komunave nga perspektiva komunale:

- **Besim Halimi**, Viti/Vitina
- **Gradimir Mikic**, Mayor of Ranillugë/Ranilug
- **Bajrush Ymeri**, Mayor of Artanë/Novo Brdo
- **Mehmet Krasniqi**, Mayor of Kastriot/Obilic
- **Rufki Suma**, Mayor of Hani i Elezit
- **Vllaznim Maloku**, Junik

**Besim Halimi (Përfaqesues i Vitisë)**, ne prezantimin e tij tha se gjatë 2011 kane pasur sfida dhe përparime. Ndarja e komunës së Kllokotit ka ndikuar në probleme kadastrale dhe ato buxhetore. Ai tha se procesi i decentralizimit po ashtu ka zvogëluar dhe numrin e banorëve. Pas miratimit të statutit, kryetari ka marrë vendim për vendosjen e bazës ligjore për funksionalizmin e administratës. Në proces ka ndodhur që disa dikastere të centralizohen nga ana e ministrive. Kontrolli nga lart-poshtë i ndërmarrjeve publike si ajo e ujit, mbledhjes së mbeturinave. Sipas tij është e rëndësishme të krijohet një bazë ligjore për aspektin e menaxhimit të këtyre ndërmarrjeve. Tani vonë ka ndodhur dhe centralizmi inspeksionit. Shembull i mirë i procesit të zbatimit të regjistrimit të bizneseve duhet të na shërbej si model. Gjithashtu ai tha se gjatë vitit 2011 kane investuar në sheshe, rrugë, ujësjellës..., kemi bërë lirim nga taksat për arsye të stimulimit të bizneseve. Jemi në takime të vazhdueshme për të gjetur mënyra të bashkëpunimit me sektorin privat.

**Z. Gradimir Mikic, Kllokot**, ne prezantimin e tij tha se persa i përket decentralizimit ata kane marrëveshje bashkëpunimi sepse ata nuk jane ndare kur s'kane dashur të ndahen nga komuna e Kamenicës. Gjithashtu tha se vërehet përparim sidomos në infrastrukturë e shkollim por ajo që i shqeteson është përpjekja për centralizim, pasi janë marrë shumë kompetenca për arsimin. Ai u shpreh se kane probleme shumë të madhe me tokat publike. Aspekti tjetër është plani Ahtisari që në të nënkuptohet një përmbledhje e ligjeve. Ai theksoj se s'ka asgjë me pavarësinë e Kosovës por decentralizmi ka themeluar komuna me 5 mije banore dhe kanë mbetur komuna me 300 mije banor. Sipas tij, procesi duhet të vazhdojë me ofrimin e shërbimeve tek qytetarët.

**Z. Mehmet Krasniqi, Obiliq**, tha se problemet dhe sfidat e komunave janë të ngjashme. Sipas tij buxheti i varfër që kanë pushtetet lokale i determinon punët dhe sukseset. Mos pasja e kompetencave mbi ndërmarrjet publike perben shkeljen e ligjit. Sipas tij ne Kosovë thuhet se ka decentralizim të kompetencave, por për dite ndodh centralizimi. Komunitat kane probleme në kuptimin e menaxhimit të pronave publike. Nëse kjo qasje vazhdon në cenimin e kompetencave atëherë humbet kuptimi i mandatimit qytetare. Ai tha se në 5 linjat buxhetore kane 99 % shpenzim dhe se ka ndodhur zhvillim i rëndësishëm në raport me bashkëpunimin me bizneset. Kryetarët e Komunave i kanë duart e lidhura për reformat në administratë. Komuna e Obiliqit në muajt e kaluar ka pasur gjendje emergjente dhe këtu është treguar bashkëpunimi me qytetarë.

**Z. Refki Suma, Hani i Elezit,** ne prezantimin e tij tha se flitet shumë për decentralizimin , por a mund të themi se ka reformë të pushtetit lokal. Ai tha se ju imponohet themelimi i kompanive lokale dhe se qeveria ju është përgjigjur me vërejtje. Sipas tij flitet për decentralizimin dhe kane centralizim , jo vetëm në zjarrëfiksit por dhe ne inspektoratet. Ai thote se ende nuk i kane zyrat e regjistrimit të automjeteve, zyrat e punësimit. Tek ligjet ka shumë kundërthënie se një ligj e lejon tjetri e ndalon. Ligji i punës thotë se punëtorit i takon 30 minuta pauzë ligji për shërbyesit civil thotë 1 orë . Ligjit për shërbimin civil thotë se për dy vite punë takon pushin një ditë pushim , tek ai i punes 5 vite pune 1 dite pushim . Tek pyjet ne i ruajmë ato ndërkaq qeveria i merr mjetet. Ne rastin e shitjes se ndërmarrjeve publike neve na takoj 5% të shitjes dhe ne ende si kemi marrë. Sipas tij ata gjenden në shumicën e rasteve ne mes te ligjeve dhe interesit të qytetarëve.

**Z. Vllaznim Maloku (përfaqësues i Junikut),** ne prezantimin e tij tha se mendon se komunat kanë specifika të ndryshme dhe se do të ishte mirë një studim i fizibilitetit në raport me specifikat dhe buxhetin. Kur planifikohet buxheti, rreth 30 % shkojnë për investime kapitale, 30 % paga dhe mëditje, 30 % në investime. Ai theksoi se eliminimi i politizimit tek shërbyesit civil është shumë i rëndësishëm. Harmonizimi i legjislacionit duhet të ndodhë nga niveli qendror dhe ai lokal, dhe të përshtaten në bazë te specifikave. Gjithashtu duhet te kete bashkëpunimi në mes komunave fqinje dhe duhet te kete harmonizimi te politikave. Ai shtoj se eshte i rendesishem shfrytëzimi i resurseve natyrore, në bashkëpunimin ndër-komunal.

**Z. Bajrush Ymeri, Novobërdë,** ne prezantimin e tij tha se territori i Novobërdës është ne disproporcion me numrin e qytetarëve ndërkaq buxheti ndahet në raport ne numrin e tyre. Ai tha se qeveria i përkrah në shtimin e ofrimit të shërbimeve dhe jo të stafit. Sipas tij diskriminohen në ndarjen e buxhetit. Ai tha se problemi më i madhe del në bartjen e resurseve sepse territori është zgjeruat ndersa resurset nuk janë bartur. Pra, ka ndodhur transferimi i i përgjegjësise, por jo i resurseve Me gjithë këto sfida ne jemi munduar t’ja dalim, përfundoi ai.

## SIGURIA NË NIVELIN KOMUNAL

### Moduli/Tema:

- Siguria në Nivelin Komunal
- Marrëdhëniet ndërmjet Shërbimit Policor dhe Komunave  
Historia, sfidat dhe perspektiva e sigurisë në nivel komunal
- Si të fuqizohet Sundimi i Ligjit dhe Siguria e Komunitetit në nivel lokal – Raportet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë dhe Komunës
- Vizitë në Policinë e Kosovës – takim me Drejtorin e Policisë së Kosovës – Lokacioni: Shtabi Qendror i Policisë takim me

### Ligjërues:

- **Z. Arbër Gorani**, Ligjërues në **Kolegjin ISPE** dhe ish Drejtues i Grupit Punues të Tranzicionit Qeveritar për Sundimin e Ligjit
- **Z. Fisnik Rexhepi, Mr. Sc**, Këshilltar i Lartë i Ministrisë së Punëve të Brendshme
- **Z. Besnik Tahiri**, Drejtor në KLGI
- 

**Data:** 6 Mars, 2012

**Vendi:** Prishtinë

Synimi i këtij moduli është që të shtjellojë marrëdhëniet ndërmjet Shërbimit Policor dhe Komunave, historine, sfidat dhe perspektiva e sigurisë në nivel komunal. Në këtë modul u trajtuan edhe diskutuan tema për fuqizimin e ligjit dhe sigurinë e komunitetit në nivel lokal si edhe raportet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë dhe Komunave. Për këtë arsye KLGI ka ftuar Z. Arbër Gorani, Ligjërues në Kolegjin ISPE dhe ish Drejtues i Grupit Punues të Tranzicionit Qeveritar për Sundimin e Ligjit si edhe Z. Fisnik Rexhepi, Këshilltar i Lartë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të diskutuar rreth këtyre çështjeve.

Z. Arbër Gorani filloi prezantimin e tij duke folur për evulimin në lëmi të studimeve të sigurisë, në ndryshimin e fokusit të institucioneve tradicionale të sigurisë. Gjithshtu, në krijimin dhe konsolidimin e elementeve të arkitekturës së sigurisë në Kosovë si dhe në krijimin dhe konsolidimin e konceptit të policisë në komunitet. Sipas tij, evulimi i lëmisë së Studimeve të Sigurisë; Nga sigurizimi dhe siguria ushtarake dhe vazhdohet me sigurinë shoqërore, mjedisore dhe ekonomike. Ai tha se studimet e sigurisë kanë të bëjë me kërcënimet ndajmbijetesës përdorisë lufta dhe kërcënimet për të përdorur forcën janë pjesë e ekuacionit të sigurisë dhe nuk janë ekskluzive; Por ai pohoi se përkufizimi ka ndryshuar meqë në rreziqe hyjnë edhe pandemitë, si HIV/AIDS, degradimi mjedisor, dhuna e drejtëpërdrejtë, terrorizmi dhe konflikti ndër-shtetëror; Evulimi i lëmisë së Studimeve të Sigurisë; Sigurizimi, u soll në literaturë nga Instituti për Kërkime Konfliktive dhe të Paqes në Kopenhagë, dhe ka të bëjë me atë se kërcënim i sigurisë është përcaktim i elitës për elemente të sigurisë që është çështje subjektive e elitave të merren me një emergjencë të caktuar. Autori Ralf Emmers e shpjegon këtë në kontekstet e ndryshme duke filluar nga reagimi Australian ndaj emigracionit e deri te pushtimi i Irakut në vitin 2003; Fjalët e reja në studime të sigurisë janë edhe Siguria Njerëzore, ka të bëjë me konceptin e kritikizmit ndaj shtetocentrizmit të qasjes tradicionale dhe ka objekt referues lidhjen meszhvillimit dhe sigurisë; Evulimi i lëmisë së Studimeve të Sigurisë; Siguria politike

ka të bëjë me kërcënimet e jashtme (probleme me njohjen) dobishmëria e saj më e madhe gjendet me kërcënimet e brendshme (problemet me ligjitimitetin) ndaj regjimit. Emërtimi siguri e regjimit ka të bëjë më dimensionin e jashtëm dhe të brendshëm; Siguria ushtarake ‘streha apo shtëpia’ e konceptit tradicional të elemneteve përbërëse të sigurisë (bazuar në Eric Herring). Por, bazuar në sigurizim dhe kontruktivizëm ka mundësi që të thellohet kuptimi i sigurisë më tepër; Evulimi i lëmisë së Studimeve të Sigurisë; Kthimi i vëmendjes së sigurisë brenda shteteve (jo vetëm jashtë shteteve shembuj Kriza e raketave në Kubë): gjysmë milioni njerëz vdesin çdo vit nga armët e lehta, 40.000 njerëz çdo ditë vdesin nga uria. Richard Jackson thotë: ‘Ekziston një ndarje e thellë midis llojit të sigurisë që gëzon një grup i vogël kombesh të zhvilluara dhe llojit të ambientit të sigurisë që të banuar nga shumica e banorëve të botës.’ Regjimet qeverisëse në vënd që të bëhen garantuese të sigurisë bëhen burim kryesor i pasigurisë së njerëzve; Relevnat nocioni dilemë pasigurie jo vetëm që ekspozon natyrën spirale të dhunës, por edhe sa problematike është gjetja e zgjidhjes së saj. Evulimi i lëmisë së Studimeve të

Sigurisë; Siguria shoqërore parashtrahet si alterantivë ndaj sigurisë ndaj shtetit dhe në të vërtetë ndaj individit; nocioni i një kolektivi njerëzish; shqyrtimi i dinamikave përtej konflikteve etnike; casja për zgjidhjen e kësaj pasigurie jo-vetëm ushtarake; Siguria ambientale, edhe gjatë viteve u shfaq shqetësimi për hollimin e shtresës së ozonit filloi të koncipohet si një ‘kërcënim i ri’ i sigurisë; Evulimi i lëmisë së Studimeve të Sigurisë; Siguria ekonomike; ekonomia e një shteti dhe aksesin që ka ky në resurset janë komponente esenciale që përcaktojnë aftësinë e një shteti për t’u mbrojtur nga një mjedis anarki bazuar në parimin e vetëmbrojtjes; Pastaj çështjet si pandemia e HIV/AIDS (çdo ditë mesatarisht vdesin tri herë më shumë njerëz nga AIDS se sa numri i të vrarëve më 11 shtator 2001; Ndryshimi i fokusit të institucioneve tradicionale të Sigurisë; Këto ndryshime ndikuan në ndryshime jo vetëm të axhendës së sigurisë në shumë vende, por edhe në legjislacion dhe objektiva të organizatave ndërkombëtare; Ndryshimet në ushtri dhe krijimi i njesiteve CIMIC; Ndryshimet në polici dhe policia në komunitet; Ndryshimi i fokusit të institucioneve tradicionale të Sigurisë; Përvojat e vendeve tjera:

- Gjermania;
- Mbretëria e Bashkuar;
- Spanja;

Vendet në rajon:

- Shqipëria; dhe
- Maqedonia.

Krijimi dhe konsolidimi i elementeve arkitekturës së sigurisë në Kosovë; Nga 2003 në 2012; Nga Rregullorja e UNMIK-ut 2005/54 e deri te Ligji mbi Policinë; Nga Standardet për Statusin në Pakon e Presidentit Ahtisari Krijimi dhe konsolidimi i elementeve arkitekturës së sigurisë në Kosovë; Aktualisht ekziston një strukturë ligjore dhe e strategjive ç’adreson sigurinë në komunitet; Deri tani forumet e sigurisë janë themeluar në shumicën e komunave të Kosovës nga viti 2004. Rreth 22 KKS, 32 EVSB dhe 27 KSBL janë themeluar; Janë të themeluar mekanizmat sipas rregullativës aktuale dhe praktikave kraktike; Ekziston një përkrahje nga aktorët/partnerët lokal dhe ndërkombëtar. Krijimi dhe konsolidimi i elementeve arkitekturës së sigurisë në Kosovë; Misioni i kësaj strategjie është të përcaktojë

prioritet strategjike, përcaktojnë objektivat strategjike të institucioneve që janë kyqyr, dhe të harmonizojë veprimet ndër-institucionale në mënyrë që të arrihen objektivat me interes kombëtar. Po ashtu, misioni i kësaj strategjie është të sigurojë kualitetin e shërbimeve, konsulencës dhe sigurisë njerëzore duke zvogëluar rreziqet dhe sfidat që direkt i atakojnë qytetarët dhe i intensifikojnë politikat preventive. Krijimi dhe konsolidimi i elementeve arkitekturës së sigurisë në Kosovë; Ligji i Policisë Nr. 03/L-035:

**Si të fuqizohet Sundimi i Ligjit dhe Siguria e Komunitetit në nivel lokal – Raportet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë dhe Komunës.**

**Mr. Sc. Arbër Gorani**, Ligjërues në Kolegjin ISPE dhe ish Drejtues i Grupit Punues të Tranzicionit Qeveritar për Sundimin e Ligjit .

**Fisnik Rexhepi, Mr. Sc.**, Këshilltar i Lartë i Ministrit të Punëve të Brendshme.

Z. Arber Gorani: Sa u përket strukturave dhe reformave mendoj se është bërë shumë për një periudhë të caktuar deke pas parasysh konceptin e pa njohur.

Z.Fisnik Rexhepi: Tani ka filluar që koncepti i siguris së individit të marrë rëndësinë që ka. Qeveria ka aprovuar strategji për parandalimin e krimit dhe atë të sigurisë në bashkësi. Konsolidimi i mekanizmave paralajmërimit të hershëm. Paralelisht me EVSB, KKSB dhe atë të siguri në bashkësi . Policia nga viti I kaluar ka filluar një formë të re atë të policimit. Në të gjitha sondazhet Policia e Kosovës është mekanizmi më i besueshëm. Por nëse e shohim bashkëpunimin me qytetarët atëherë ka vend për përmirësim. Bashkëpunimi në mes MPB-së , komunave dhe qytetarëve kemi situata të ndryshme : Operacioni i policisë në një komunë i cili u zhvilluar me kërkesë të qytetarëve . Krimet e sigurisë publike janë problematikat kryesore për komunat. Tani më dëshirojmë të ndërtojmë një polici parandaluese (preventive) e jo të merrmi më pasojat kjo bëhet në bashkëpunim me qytetarët dhe me informacionet që marrim nga ta, me një flalë një polici inteligjente.

## SISTEMI I DECENTRALIZUAR I QEVERISJES; MENAXHMENTI DHE FINANCAT; ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL (KONCEPTI DHE PRAKTIKAT)

### MODULI KATËR

#### Moduli/Tema:

- Sistemi i decentralizuar i Qeverisjes
- Menaxhmenti dhe financat
- Zhvillimi ekonomik lokal ,Koncepti dhe praktika
- Financimi i qeverisjes lokale – Sistemi i suksesshëm i decentralizuar i qeverisjes

#### Ligjërues:

- **R. Andrew Nickson**, Lexues Nderi në Shkencat e menaxhimit publik dhe të Amerikës Latine, Universiteti i Birmingham-it
- **Besnik Tahiri**, drejtor Ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale

**Data:** 10 mars 2012

**Vendi:** Prishtinë

Qellimi i ketij moduli është që të tregojë mbi sistemin e decentralizuar të qeverisjes. Temat që do të diskutohen janë ato për menaxhmentin dhe financat, zhvillimin ekonomik lokal. Për këtë arsye KGLI ka ftuar **R. Andrew Nickson**, Lexues Nderi në Shkencat e Menaxhimit Publik dhe të Amerikës Latine, Universiteti i Birmingham-it për të treguar nga përvoja e tij me vendet e tjera lidhur me temat.

Z.Nickson filloi prezantimin e tij duke paraqitur aspektin shkencor dhe praktika nga vendet e tjera. Ai tregoi një shembull mjaft interesant se si asociacioni i komunave të Anglisë ka dërguar një delegacion në Amerikën Latine , për të marrë përvoja. Ai filloi me shpjegimin e disa koncepte bazike sic është dallimi midis qeverise lokale dhe qeverisjes lokale si dhe decentralizimi. Qeverisja lokale është mënyrë që ofrimi i shërbimeve të bëhet në nivelin lokal , por edhe që duhet të kemi të zgjedhur .Disa vende kanë disa nivele të qeverisjes dhe theksoj se Kosova është me fat që ka sistemin dyshkallësh. Në Peru p.sh. kanë qeverisjen qendrore , qeverisjen rajonale dhe atë lokale dhe një nënsistem me të ulet shpjegoj ai. Qeverisja lokale ka dale vone. Sipas tij ideja e qeverisjes lokale të zgjedhur përmes votës ,përmes qytetareve ,përmes shoqërisë civile dhe të rinjve ,behet që të ofroj shërbime në vije me atë që kërkohet .Në duhet të bëjmë një dallim mes qeverisjes lokale thelbësore dhe asaj lokale , e tera varet nga ndërveprimi dhe përkushtimi. Decentralizimi është proces i ndërrimit të fuqive . Ky është trend global drejt decentralizimit. Sipas tij në njëzet vitet në vijim do të shohim të kundërtën, këtë e quajti si revolucion i heshtur dhe se në këtë proces janë tri komponent:

- Komponentë politike, kjo është forca shtytëse.
- Aspekti fiskal
- Aspekti administrativ, aranzhimi për çështje problematike



Ai tha se efektet e programit të decentralizimit kanë dy dallime : atë të realitetit dhe të reformës Ballkani për dallim nga vendet e tjera , në aspektin administrativ është mjaft i decentralizuar.

DONS ka bërë dallime në mes të decentralizimit në tre hapa:

- Dekoncentrimi (shkëputja) nga qendra tek zyrat e njëjta të të njëjtës ministri . Mirëpo këto mund edhe të ndryshohen të rikthehen ku kanë qenë.
- Delegimi , kjo preferohet shumë, transferimi nga qeveri te niveli lokal
- Transferimi i përgjegjësive te nivelet me të ulëta politike .

Të gjitha këto ndërveprojnë. Aspektet kyçe të devolucionit që lidhen me aspektet e demokratizimit , kanë idenë kyçe që të bëjnë qytetarin t'i besoj shtetit. Mendimi i tyre për shtetin konceptohet në atë që e kanë me afër .Fuqitë lokale në devolucion janë të rregullimi me ligj, tek ju si ka ndodhur procesi ?

**Z.Besnik Tahiri:** Decentralizimi ka qenë plani vendosës për ndërtimin e shtetit. Deklarata e principeve dhe ligjet duhet të rishikohen dhe t'u përshtatën kohës

**Z.Nikson:** Kjo është kryesore që të ketë resurse financiare të pavarura ,jo vetëm për të mbledhur para por edhe për të vendosur digresion. Mbretëria e Bashkuar është një vend i centralizuar ku qeveritë lokale kanë një rol të rëndësishëm .Qeveria qendrore iu jep shumë para por nuk u lejon ti shpenzojnë sipas nevojave.

Qeveritë lokale në Angli kanë reputacion të mirë në raport me politikat publike. Por pare në vendin time ka ndodhur ta vendosin një person në krye të shërbimit civil dhe kështu ka pasur kontroll mbi administratën.

Koordinimi në nivelin lokal: Si ndërveprojnë të zgjedhurit dhe administrata? Çka ndodhë me rast të bartjes së kompetencat nga ministria në qeveritë lokale?. Të gjithë ata punëtor ende e shikojnë qeverinë si lider në vend që të shikojnë në mënyrë horizontale . Tek ju a ka ndodhur ky problem?

**Z.Besnik Tahiri:** Ne kemi problem me strukturat paralele.

**Z.Nikson:** Kjo është përvojë tjetër dhe është unike. Centralizimi në shumë vende ndodh në raste të krizave dhe unë kam shkruar për këtë temë . Pas Luftës së dytë ka qenë një centralizim i madh për shkak ndoshta edhe të BRSS. Në vitet e 80-ta ka ndodhur edhe një rivlerësim. Nëse me pyet dikush nga ka ardhur ky presion në shumicën e vendeve ka ardhur nga lart. Arsye pse ka ardhur është për shkak të fondeve ndërkombëtare, të ngritën të hyrat në nivel lokal . Neoliberalët mendojnë se decentralizimi e ul fuqinë e nivelit qendrore. Teknokratet thonë se për definimin e shërbimeve me efektive duhet të arrihet përfshirja.

Argumentet për decentralizimin: Fuqizimi demokratik ,ekonomik dhe administrativ. Qeveritë lokale i kanë më të qarta nevojat e qytetareve. Qytetaret janë më aktiv dhe alokimi i mjeteve financiare bëhet sipas nevojave të tyre.

**Z.Besnik Tahiri:** Decentralizimi është duke u diskutuar shumë , ka argumente pro dhe kundër. Të diskutojmë aspektet politike , fiskale dhe ato administrative . Problem tjetër i madh është edhe çështja e korrupsionit.

**Z.Nikson :** Nëse ne mendojmë se korrupsioni është ngritur , atëherë përgjigja është të fuqizojmë qytetaret për monitorim. Mekanizmi i ri-therrjes , nëse qytetaret kanë brenge atëherë kemi një vendim, kjo është ana formale për të gjetur zgjidhje. Ne

aspektin afatgjatë nëse korrupsioni është në rritje dhe se qeveria lokale nuk është duke informuar , atëherë ti fuqizojmë ligjet për transparencën dhe çështjet e financave. Duke pasur këtë mekanizëm se si epet kontrata dhe si merren vendimet .Dhe e treta që është më shumë afatgjate; fuqizimi i qytetarëve në qeverisjen lokale , ku grupet e qytetareve takohen për te pare performancën. Këto janë tri anët e strategjisë por nuk është e lehtë. Në fund mendoj se arsimi për agjendën kundër korrupsionit është shume i rëndësishëm. Në Singapor kjo ka ndodhur dhe ka filluar të krijohet ideja për demet që shkakton korrupsioni.

### **Financimi i qeverisjes lokale – Sistemi i suksesshëm i decentralizuar i qeverisjes**

**R. Andrew Nickson**, Lexues Nderi në Shkencat e menaxhimit publik dhe të Amerikës Latine, Universiteti i Birmingem-it.

**Z.Besnik Tahiri:** Tema e radhës do të jete aspekti financiar. Kryesuesi i Obiliqit ka bërë një pyetje për çështjet e interesit nacional siç është KEK-u.

**Hajriz Bekteshi:** U tha se në Kosove jemi te pajisur me infrastrukture ligjore , thuhet se komnat janë përgjegjëse për zhvillimin lokal. Nga mendimi dhe përvoja vendet që kane interes nacional si i trajtojnë ato komuna. Ne nga kjo marrim vetëm taksen në pronë.

**Z.Nikson:** Mendoj se kjo është e lidhur me atë që po ndodh në Kinë. Si qeveri lokale duhet të kompensohen për dy gjera: për çështjen e eksploatimit dhe ambientit. Te çështja e ambientit është e rëndësishme të ketë politika nacionale ngase komnat nuk kane kapacitete. Në termat praktik thuhet se qeveritë lokale nuk kane kapacitete siç është për shembull çështja e mbrojtjes se ujit. Është përgjegjësi e qeverise dhe ju mendoni se kjo tek ju nuk po ndodh. Por ju duhet të ndërmerri veprime ligjore .Në pyetjen e kompensimit për humbjen e burimeve të pa-ripërtrishme , në vendet tjera kompensohen këto humbje. Ekziston një problem ngase kemi një pagese nga ndërmarrjet dhe se taksat nuk duhet të shkojnë vetëm në nivel qendror, por edhe ne atë lokal . Nganjëherë këtu pagesa për nivelin lokal janë shume të mëdha dhe se komuna ka një popullsi të vogël, dhe këtu krijohet disbalanc në mes të komunave dhe komnat tjera thonë se kjo nuk është e drejt. Pse duhet të kompensohen dhe të mos prishet balanci në vije horizontale. Në Peru ka një minierë dhe komuna është shumë e pasur, kurse vendi në përgjithësi është i varfër.

**Bekim Saliu:** Është rast i mirë të kemi një profesor të kalibrit të tillë . Një thënie e Joshua Goldstain thotë se lufta nuk bëhet për territore por për ata qe çka kane ato .Pyetja ime është për Prishtinën ku komuna merr financa sa Ranillugu , si është e rregulluar në vendet e tjera çështja e kryeqytetit?

**Z.Nikson:** Në të kaluarën në shumë vende kanë pasur klasifikim të komunave dhe kjo është bërë në bazë të popullsisë. Ky trend është reduktuar në mase të madhe dhe ligjet nuk i ndajnë dhe i japin të njëjtat kompetenca. Ne mund të flasim për mënyrën e Francës, për asociacionet e komunave që është unike. Në Britani kemi 600 komuna , ndërkaq në France kemi 36.000 por ka vende që çështjen e kryeqytetit e rregullojnë ndryshe për shembull ËASHINGOTN D.C ka një ligj të veçantë. E kemi sistemin e qyteteve metropolitane . Në shume vende kryeqytetet i kane kompetencat e njëjta me të tjerat . Unë nuk shoh një veçori t’i japim Prishtinës kompetenca speciale

**Z.Besnik Tahiri:**Sidoqoftë ne nuk pajtohemi .Konteksti i Kosovës është rast i veçantë në aspektin e të hyrave ngase kemi disbalanc të thelle të të hyrave në mes komunave

.Shumica e vendeve kanë nga një ligj të veçantë që e rregullon elementet e funksionalizimit të kryeqytetit për shkak të koncentrimit.

### Zhvillimi ekonomik lokal, konceptet dhe praktika

R. Andrew Nickson, Lexues Nderi në Shkencat e menaxhimit publik dhe të Amerikës Latine, Universiteti i Birmingham-it.

**Z.Nikson:** Nëse kemi qeveri të decentralizuar duhet të kemi qeveri lokale. Ne duhet të kemi taksa lokale ngase financat që i marrim nga qeveria ato janë të destinuara dhe komunat duhet të kenë para për shfrytëzim. Me termin për efektivitetin taksat janë të lidhura me prioritetet e qytetareve. Fusha e dyte e principit është ajo e bilancit vertikal dhe horizontal. Resurset financiare duhet të përputhen me ndarjen e përgjegjësisë. Këtu dua të reflektoj në dy gjera:

- Duhet të japim para shtesë në bazë të specifikave dhe duhet të marrim parasysh kapacitete për arkëtim.

Kjo shpije drejt distribuimit të barabartë. Këto janë disa nga taksat kryesore. Një e hyrë e madhe në vendin tonë është dhe nga parkingjet.

- Tek taksat e rëndësishme është të mbledhim taksa që nuk kanë shpenzime të mëdha Administrative.

Këto taksa duhet të jenë në relacion që mos ti ngarkojnë qytetarët. Tatimi kryesor është tatimi në pronë. Një nga disavantazhit e tatimit në pronë është se janë jo elastike dhe ka tendenca se nuk mund të ngiten në mënyre proporcionale. Nga ana praktike ajo është e vështirë ngase është problematik dhe ingranimi i pronave të reja. Në aspektin administrativë merr kohë dhe punë . Në disa vende kjo lejon dhe shpërdorime në aspektin politik , ngase lirohen nga kjo taksë me arsyetimin se kanë ndihmuar në çështjen e bamirësisë. Më vjen keq që u nguta të përfundoj këtë prezantim ngase më kërkuan kohë për debat.

**Z.Besnik Tahiri :** Aspekti i financave të komunave është duke u bërë temë debati të gjerë për shkak të bartjes së kompetencave dhe jo resurseve. Ne kemi ende probleme në inkasim . Baza e mbledhjes së të hyrave nuk është ekspluatuar mjaftueshëm.

**Z. Nikson:** E thash se po barten kompetenca por jo resurse. Zgjidhja afatgjatë për këtë është të kemi një të bëhet presion nga komunat në mënyre kolektive dhe të negociohet me qeverinë qendrore.

**Z.Besnik Tahiri:** Po fillojmë e me sesionin e pas ditës . Po flasim për zhvillimin ekonomik lokal. Ajo çka është shumë e rëndësishme të bëni si komuna është përpilimi i dokumenteve strategjike zhvillimore.

**Z. Nikson:** Shkalla e lartë e papunësisë në moshën e re këtu është shumë e madhe. Dokumentet strategjike janë shumë të mira , por janë të dobëta në realitet në rast se nuk korrespondon me specifikat e vendit. Zhvillimi ekonomik lokal nuk ndodh pa krijuar ambiente të favorshme për investime. Shteti duhet të krijoj ambientin për investime. Në Angli deri tani prioritet ka qenë ndërtimi i një shoqërie të shëndoshë dhe të arsimuar. Tash është duke u punuar shumë në infrastrukturë . Aspekti tjetër i zhvillimit lokal është që të krijoj tregje lokale promovuese. Këto janë pikëpamje tradicionale për zhvillimin lokal. Tani iden për zhvillimin lokal në aspektin global kanë marrë rol Qeveritë Lokale, por megjithatë tek makroekonomia përgjegjëse është

Qeveria Qendrore. Tani më me rritjen e rolit të qeverive lokale koncepti zhvillimor ka ndryshuar dhe kërkon më shumë përkushtim dhe ekspertizë. Në vendin tim ka administratë konservative. Ide e veçantë është ndërtimi i rrjeteve . Duhet të ketë vizion strategjik dhe debate të gjëra publike në mes qytetarëve, bizneseve dhe qeverisjes. Në idetë e reja akademike ka rol të rëndësishëm ndërveprimi i akterëve për zhvillim. Dua ta marr shembull Gjermanin atje kemi një dekoncentrim të zhvillimit të bizneseve te mesme dhe të vogla kryesisht tradicionale , ato kanë lidhje të forta me komunën. Pra duhet të keni dialog të përhershëm me bizneset në baza të rregullta . Duhet ketë dhe traditë apo kulturë politike të qytetit për bashkëpunim. Dhe në fund ne duhet të marrim parasysh aspektet e veçanta të qytetit. Ideja e zhvillimit ekonomik lokal është më e madhe në ato komuna që ka më shumë traditë. Sa më shumë akter të kyçur aq më i madh është ndryshimi. Këto janë disa nga aktivitetet që shpjegojnë ndërveprimin ku qeveritë lokale të jenë pionier të zhvillimit që duhet të sjellin njerëzit së bashku në mënyrë që ata ti shohin nevojat e tyre për zhvillim ekonomik.

Fusha e dyte e principit është ajo e bilancit vertikal dhe horizontal. Resurset financiare duhet të përputhen me ndarjen e përgjegjësisë. Këtu dua të reflektoj në dy gjëra:

- Duhet të japim para shtesë në bazë të specifikave dhe duhet të marrim parasysh kapacitete për arkëtim.

Kjo shpije drejt distribuimit të barabartë. Këto janë disa nga taksat kryesore. Një e hyrë e madhe në vendin tonë është dhe nga parkingjet.

- Tek taksat e rëndësishme është të mbledhim taksa që nuk kanë shpenzime të mëdha Administrative.

Këto taksa duhet të jenë në relacion që mos ti ngarkojnë qytetarët . Tatimi kryesorë është tatimi në pronë. Një nga disavantazhit e tatimit në pronë është se janë jo elastike dhe ka tendenca se nuk mund të ngriten në mënyre proporcionale. Nga ana praktike ajo është ë vështirë ngase është problematik dhe ingranimi i pronave të reja. Në aspektin administrativë merr kohë dhe punë . Në disa vende kjo lejon dhe shpërdorime në aspektin politik , ngase lirohen nga kjo taksë me arsyetimin se kanë ndihmuar në çështjen e bamirësisë. Më vjen keq që u nguta të përfundoj këtë prezantim ngase më kërkuan kohë për debat.

**Z. Besnik Tahiri:** Aspekti i financave të komuneve është duke u bërë tem debati të gjerë për shkak të bartjes së kompetencave dhe jo resurseve. Ne kemi ende probleme në inkasim . Baza e mbledhjes së të hyrave nuk është eksploatuar mjaftueshëm.

**Z. Nikson:** E thash se po barten kompetenca por jo resurse. Zgjidhja afatgjatë për këtë është të kemi një të bëhet presion nga komunat në mënyre kolektive dhe të negociohet me qeverinë qendrore.

**Z. Besnik Tahiri:** Po fillojmë e me sesionin e pas ditës. Po flasim për zhvillimin ekonomik lokal. Ajo çka është shumë e rëndësishme të bëni si komuna është përpilimi i dokumenteve strategjike zhvillimore.

**Z. Nikson:** Shkalla e lartë e papunësisë në moshën e re këtu është shumë e madhe. Dokumentet strategjike janë shumë të mira , por janë të dobëta në realitet në rast se nuk korrespondon me specifikat e vendit. Zhvillimi ekonomik lokal nuk ndodh pa krijuar ambiente të favorshme për investime. Shteti duhet të krijoj ambientin për investime. Në Angli deri tani prioritet ka qenë ndërtimi i një shoqërie të shëndoshë dhe të arsimuar. Tash është duke u punuar shumë në infrastrukturë . Aspekti tjetër i zhvillimit lokal është që të krijoj tregje lokale promovuese. Këto janë pikëpamje

tradicionale për zhvillimin lokal. Tani idenë për zhvillimin lokal në aspektin global kanë marrë rol qeveritë lokale, por megjithatë tek makroekonomia përgjegjëse është qeveria qendrore. Tani më me rritjen e rolit të qeverive lokale koncepti zhvillimor ka ndryshuar dhe kërkon më shumë përkushtim dhe ekspertizë. Në vendin tim ka administratë konservative . Ide e veçantë është ndërtimi i rrjeteve . Duhet të ketë vizion strategjik dhe debate të gjëra publike në mes qytetarëve, bizneseve dhe qeverisjes. Në idet e reja akademike ka rol të rëndësishëm ndërveprimi i akterëve për zhvillim .Dua ta marr shembull Gjermanin atje kemi një dekoncentrim të zhvillimit të bizneseve të mesme dhe të vogla kryesisht tradicionale , ato kanë lidhje të forta me komunën. Pra duhet të keni dialog të përhershëm me bizneset në baza të rregullta . Duhet ketë dhe traditë apo kulturë politike të qytetit për bashkëpunim. Dhe në fund ne duhet të marrim parasysh aspektet e veçanta të qytetit. Ideja e zhvillimit ekonomik lokal është më e madhe në ato komuna që ka më shumë traditë. Sa më shumë akter të kyçur aq më i madh është ndryshimi. Këto janë disa nga aktivitetet që shpjegojnë ndërveprimin ku qeveritë lokale të jenë pionier të zhvillimit që duhet të sjellin njerëzit së bashku në mënyrë që ata t'i shohin nevojat e tyre për zhvillim ekonomik.

## RAJONALIZIMI, DEMOKRATIZIMI, DIALOGU DHE DECENTRALIZIMI

### Moduli/Tema:

- Rasti i Tirolit te jugut
- Bshkëpunimi ndërkomunal. Koncepti dhe praktika
- Mbrojtja e Minoriteteve dhe marrëdhëniet e aranzhimeve autonome asimetrike midis Triolit te Jugut dhe Republikës së Kosovës
- Si të rregullohet Veriu i Kosovës-Zgjidhjet nga presepektiva e qeverisjes lokale dhe decentralizimi
- Bashkëpunimi Ndëe- Komunal si një mjet për zhvillim e qeverisjes lokale. Rasti i Kosovës, legjislacioni , Koncepte dhe praktikat
- Prakushtet dhe sukseset për bashkëpunimin ndër-komunal-rolit I autoriteteve qendrore dhe lokale per promovimin bashkëpunimit inter-komunal. Cilat jane format e ndryshme te Bashkëpunimit Nder-komunal.

### Ligjërues:

- **Besnik Tahiri**, Drejtor ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale
- **Dr. Friedhelm Frischenschlager**, President I levizjes federlaiste Evropiane, ish minister i Mbrojtjes i Austrise dhe ish anetar I Parlamentit Evropian
- **Z.Naim Hoxha**, Këshilltar Politik-OSCE në Kosovë
- **Z.Agron Maxhuni**, Drejtor i Departamentit Ligjor ne Ministrine e Pushtetit Lokal
- **Z. Bajrarush Ymeri**, Kryetar I Novoberdes
- **Z.Mehmet Krasniqi**, Kryetar I obiliqit
- **Znj. Alba Dakoli Wilson**, Drejtoresh e FLAG në Shqiperi

Durrës, Shqipëri  
22 Mars, 2012

Dita e pare e Akademise per Qeverisje Lokale ishte shume e gjalle me diskutimet e planifikuara me axhende sic ishin Regjionalizimi ne Evropen Perendimore dhe Mbrojtja e Monoriteteve ne Nivel Lokal ne ceshtjet e papritura por te rendesishme te qeverisjes lokale sikurse metodat me te mira te zgjedhjes se Kryetareve te Komunave, masat mbrotjtese ligjore per sherbyesit civilem dhe niveli i debatit ideologjik ne Asamblene Komunale.

Akademia për Qeverisje lokale pati nderin që hapi punëtorinë e saj në Durrës në prezence të mysafirit të shquar si prof. dr. Friedhlem Frischenschlager, President i Lëvizjes Federale si edhe në prezencën e të gjithë pjesëmarrësve e te ftuarëve nga gjashtë komunat. Stafi i IKQL-së prezantoi dhe shpjegoi në mënyre më të detajuar axhendën e këtij punëtorie-I,duke theksuar se Z. Frischenschlager kishte shprehur dëshirën e tij për të diskutuar ceshtjet e qeverisjes lokale me pjesëmarrësit e AQL-së.

Sesioni i parë i punëtorise ngjalli debat të madh në AQL. Konflikti dhe Rezoluta e Konfliktit në Tyrol-in e jugut si edhe mësimet e nxjerra nga Dr. Frischenschlager për Kosovën, ngjallën pyetje dhe diskutime rreth qasjes për të bërë funksionale komunat në veri të Kosovës. Debatit u soll rreth pyetjes se a është e mjaftueshme pakoja e

Ahtisarit apo akoma ka nevojë që të akomodohen komunat e veriut në mënyrë që ato të funksionojnë sic duhet brenda kufinjëve të Kosovës.

Ndonse jo të gjithë ishin dakord me propozimet e Dr. Frischenschlager, dhe kur debati preku disa çështje që ishin shumë politike dhe kruciale për qeverisjen lokale të Kosovës, u diskutuan tema si akomodimi i minoriteteve në qeverisjen lokale dhe llojet e kompetencave dhe autonomive që i nevojiten qeverisjes lokale në mënyrë që të funksionojnë sic duhet.

Sesini vijues i AQL-së filloi me përshkrimin e strukturave të qeverisjes lokale në Austri nga Dr. Frischenschlager, i cili gjithashtu ka shëmbur aty si ministër në vitin 1980, si edhe me sfidat që është përballur ky nivel i qeverisjes. Ky prezantim i shkëlqyer me pika interesante solli diskutime midis pjesëmarrësve për eksperiencën e Kosovës me Kryetarët e Komunave të zgjedhur drejtpërdrejtë dhe nëse kjo mënyrë ka sjellë emerime politike të drejtorëve komunalë. Të zgjedhurit zyrtarë të qeverisjes lokale renditën një listë të sfidave që sollen kryetarët e zgjedhur drejtpërdrejtë ku shërbyesit civil drejtonin debatin drejt sfidave për të qënë politikisht te pa njëanshem në punën e tyre.

Gjithashtu pati një diskutim lidhur me nivelin e debatit ideologjik në Kuvendet Komunale të Kosovës nga Dr. Frischenschlager si edhe një përshkrim të politikës lokale në Austri. Shumë nga pjesëmarrësit ishin dakord se ka shumë pak debat ideologjik nëpër Kuvende Komunale dhe kjo më shumë për shkak të mungesës së ideologjisë në partitë politike të Kosovës. Theks të rëndësishëm pati fakti që Kuvendet Komunale duhet të veprojnë më shumë për të zgjidhur problemet dhe çështjet që qytetarët kërkojnë nga komunat në vend që të shqetësohen për pozicionimin e tyre në spektin politik.

Në ditën e tretë pati një fokus të diskutimeve në bashkëpunimin ndër-komunal, legjislativonin e ri si edhe mundësitë në Kosovë, pasi kjo është një zhvillim relativisht i ri në qeverisjen lokale. Drejtori i Departamentit Ligjor të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Z. Agron Maxhuni prezantoi dispozitat e reja të ligjit në bashkëpunimin ndër-komunal dhe tha se ishte alarmues fakti që ekzistonte një nivel i ulët i të kuptuarit të këtij ligji nga zyrtarët komunalë nga ana tjetër diskutimi solli nevojat e shumta që kanë komunat e ndryshme në këtë aspekt.

Në sesionin vijues, u diskutua për prezantimin e manualit “Bashkëpunimi ndër-komunal” nga IKQL-ja përfshirë këtu mundësitë që ky mekanizëm ka për zhvillimin e komunave për t’i bërë ato më efikase. Gjithashtu, ky prezantim shpjegoi me detaje se si të zhvillohen, menaxhohen dhe mbikëqyren marrëveshjet në Bashkëpunimin ndër-komunal dhe të mbeten brenda kufinjëve të ligjit të ri.

Drejtoresha ekzekutive e FLAG në Shqipëri, Znj. Alba Dakoli Wilson, solli prespektivën e Shqipërisë në bashkëpunimin ndër-komunal. Znj. Dakoli Wilson j’u pergjigj më shumë pyetjeve rreth IMC-së përse i përket ujësjellësit në Shqipëri, menaxhimin dhe grumbullimin e pleherave gjithashtu edhe rreth zhvillimit të kornizës ligjore në Shqipëri lidhur me IMC-në. Një pikë tjetër interesante për zyrtarët lokal ishte ekperiencia që komunat/bashkitë Shqiptare kishin me bërjen e studimit të fizibilitetit për IMC dhe financimet e Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve ndërkombëtar në këtë drejtim.

## DECENTRALIZIMI SËRISH I RISHQYRTUAR; ZBULIMI I RREZIKUT MORAL DHE GJETJA E OPSIONEVE; QEVERIA LOKALE DHE KOMPAKTËSIA SOCIALE

### Moduli/Tema:

- Përse është e rëndësishme për Kosovën t'i rishqyrtojë konceptet e decentralizimit dhe reformën e qeverisjes lokale
- Demokratizimi kundrejt Decentralizimit
- Përgjegjësia dhe rreziku moral i qeverisë lokale
- Llojet e Decentralizimit
- Kërkesa e ndarjes së pushtetit të shoqërive të pas luftës
- Qeveria Lokale dhe kompaktësia sociale
- Protokollit tek autoritetet e qeverisjes lokale

### Ligjërues:

- **Z. Besnik Tahiri**, Drejtor në KLGJ
- **Prof. Dr. Donald Curtis**, Specialist i Menaxhmentit Publik dhe Zhvillimit Institucional
- **Gani Demaj**, Ish-Shef i Kabinetit të Ministrisë së Drejtësisë

DATA: 23 MAJ, 2012

Vendi: Hotel Sirius, Prishtinë

Qëllimi kryesor i këtij moduli ishte rëndësia për t'i rishqyrtuar konceptet e decentralizimit dhe reformën e qeverisjes lokale. Për këtë qëllim KLGJ kishte ftuar për të treguar nga përvoja e tij mjaft e pasur dhe e larmishme Prof. Dr. Donald Curtis, Specialist i Menaxhimit Publik dhe Zhvillimit Institucional. Gjithashtu, në këtë modul u diskutuan çështjet e Demokratizimit kundrejt Decentralizimit, Përgjegjësia dhe rreziku moral i qeverisë lokale, Llojet e decentralizimit si edhe Kërkesës së ndarjes së pushtetit të shoqërive të pas luftës.

Në fund, u diskutua edhe lidhur me qeverinë lokale dhe kompaktësinë qytetare si edhe një theks te rëndësishëm pati protokollit tek autoritetet e qeverisjes lokale.

Në fjalën hyrëse Z. Besnik Tahiri theksoj rëndësinë që ka për Kosovën rishqyrtimi i koncepteve të decentralizimit dhe reforma e qeverisjes lokale. Ai theksoj se është shumë i rëndësishëm reflektimi dhe analizimi i çështjeve pasi në këtë mënyrë në nxjerrim një mësim. Prof. Dr. Donald Curtis prezantoi një dokument reflektimi i cili bazohej mbi relaitetin dhe teorinë.

Ai shpjegoi se ka shumë teori interesante lidhur me decentralizimin por reflektimet, praktikat dhe analizimet janë shumë të vlefshme në mënyrë që qeverisja lokale të zhvillohet.

Ai shpjegoi se Qeveria Lokale është një qëndër e pushtetit të individit ose të një grup njerëzish, kjo qeveri mund të jetë efektive ose jo. Sipas tij sistemet e pushtetit lokal ofrojnë



shërbime , mundësojnë zhvillim, lejonë shprehjen e identit, fuqizojnë qytetarin por nga ana tjetër problemet që përsëriten janë ato të zaptimit, tendencës separatiste kur një parti hyn në pushtet, mangësitë fiskale dhe ato të efikasitetit. Ai tha se është e rëndësishme që kushtetuta të jete fleksibël në mënyrë që të merren edhe vendime lokale. Ai theksoj se ekziston një kontratë shoqërore që lidh qytetarin me shtetin sic ka shkruar edhe filozofi i madh Rousseau, por kjo kontratë apo marrëveshje çënohet nga mangësitë e të dyjave anëve. Ai tha se kjo kontratë kjo marrëveshje është e vlefshme në kushtetutën e Amerikës dhe se qeverisjet lokale punojnë në bazë të lirive sic është liria e fjalës apo e të të shprehurit.

Gjithashtu ai shtoi se ekziston përgjegjësia dhe rreziku duke marrë si shëmbull nëse A pranon përgjegjësinë për një të mirë të përbashkët, B ka prirjen të besojë se nuk është përgjegjës dhe mund të veprojë pa përgjegjësi. Ai tha se e mira lokale është e mirë e përbashkët por kushtetutë mundësojnë zaptimin, shmangien e përgjegjësive dhe kalimin e përgjegjësisë dhe lojërat me të. Tek kalimi i përgjegjësisë prof. Curtis tha se decentralizimi në praktikë mund të përfshijë kalimin e përgjegjësive nga pushteti qëndror në atë lokal. Duke përfshirë këtu çështje të pa përshtatshme për të cilat nuk ka zgjidhje, hedhjen e fajit kur gjerat nuk shkojnë si duhet etj. Prof. Curtis theksoj tre strategji për të përcaktuar përgjegjësinë: Fleksibilitetin, ku sistemi duhet të mbetet në diskutim publik, Përzgjedhja (mos i vendosni të gjitha vezët në një shportë të decentralizimit vetëm ato të mirat të cilat qytetaria aktive rrit relevancën, cilësinë dhe mobilizimin e resurseve si edhe e treta është e rëndësishme t'u përmbahesh 'parimeve' lokalist.

Gjithashtu Prof. Curtis foli edhe lidhur me deconcentrimin i cili ka të bëjë me hapjen e zyrave lokale të qeverisë qëndrore për të kryer përgjegjësitë në mbarë shtetin. Një tipar tjetër i rëndësishëm është delegimi që ka të bëjë me dhënien e përgjegjësive specifike autoriteteve lokale , si edhe dhënien e kompetencave pushtetit lokal mbi funksione të caktuara të bartura. Nga ana tjetër ai tha se nevojat e larmishme të decentralizimit mund të përmbushen sipas një kuadëri të një sistemi unik , është e rëndësishme që të lëjohen lloje të ndryshme (federalizmi asimetrik), ekziston edhe mundësia për të decentralizuar disa funksione teksa centralizohen të tjera.

Prof. Curtis tha se ekzistojnë disa rreziqe në praktikën e decentralizimit ku përfshihen, kapja nga sektori politik i cili nuk ndjen nevojën të ndajë pushtetin për interes publik. Joefikasitetin, që rrjedh nga mungesa e stimulimit për të qënë efikas apo nga problemet e shkallës si edhe tendenca separatiste, që rrjedhin nga dështimet për të ofruar kohezionin social. Në fund Prof. Curtis theksoj janë disa elementë kryesorë që nevojitet për të inkurajuar përgjegjësitë e qeverisë, e parë është fleksibiliteti i kushtetutës dispozitat kushtetuese duhet të shqyrtohen në vazhdimësi për t'u siguruar se detyrat kryhen me përgjegjësi. E dyta, centralizo dhe decentralizo në mënyrë diferencuese, psh. tek centralizimi ai tha se duhet të centralizoni shërbimet që mund të jenë të njësuara sic janë arsimiti, shëndetësia primare. Ndërsa për decentralizimin tha se duhet të decentralizoni në qeverinë vendore vetëm çështjet në të cilat interesi i bashkësisë është i rëndësishëm së lartë, sic janë siguria në lagje, rekreacioni, planifikimi gjeografik, si edhe krijimi i kushteteve për investime, psh krijimi i një "brendi" lokal. E treta, ai tha se është e rëndësishme që t'i përmbaheni parimit të subsidiaritetit, përgjegjësitë lokale për mobilizim të resurseve lokale, kycja direkte e qytetarve në proceset e vendimarrjes, partneriteti dhe bashkëprodhimi i shërbimeve.

Z. Besnik Tahiri foli lidhur me ndenjat etike të të qënurit Kryetar Komune dhe se sa mund të bëjmë ne një vështrim etik. Sipas tij decentralizmi do të të thotë fleksibilitet dhe jo t'i përmbahesh vetëm kornizës së përgjegjësisë. Kapja, zaptimi i sistemit kur ke përgjegjësinë dhe fuqinë e ligjit. Ai tha se ne Kosovë pikë e dobët është sistemi i pambikqyrrur dhe se elementet e kontrollit mbi ekzekutivin janë shumë të dobëta.

Ai theksoj se është i rëndësishëm krijimi i mekanizmave që kontrollojnë dhe balancojnë sistemin. Sipas tij tendenca separatiste lidhet me komunat e reja ne Kosove dhe se 80% e territorit të kosoves duhet te vet kontrollohet, vetqeveriset por jo në mënyrë autonome.

Ndërsa për efikasitetin ai tha se sjell decentralizim, shërbim më të mirë dhe zbritjen e përgjegjësisë pasi decnetralizimi ka për qëllim të fuqizojë lokalitetin duke forcuar elitën.

Ai shtoj se sistemi nuk Kosovë nuk është i kontrolluar dhe se askush nuk guxon të dalë para kryetarit.

Ne fund Z. Tahiri përmëndi një thënie nga Prof. Curtis kur tha “lets go beyond structure” që do të thote demokracia lokale nuk është vetëm cfarë thotë kushtetuta, ligji por le të shkojme përpara edhe jashtë kornizës.Z.tahiri theksoj se duhet shume punë dhe nuk është e rëndësishme vetëm që te kemi strategji në letra por duhet punë në praktikë se cfarë duhet t'ju ofrosh qytetareve, është e rëndësishme të mendoni përtej asaj që jeni dhe cfarë mund t'i jepni shoqërisë, u shpreh ai.

## QEVERISJA LOKALE DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE; INTEGRIMI EVROPIAN DHE STANDARTET E TË DREJTAVE TË NJERIUT

- Procesi i integritimit evropian në BE vs Qeverisjes Lokale-Ndikimi i agjendës evropiane në transformimet shoqërore, politike dhe të aspekteve komunale
- Standartet Ndërkombëtare në nivelin lokal- Të drejtat e Njeriut detyrimet dhe barazia gjuhësore

### Ligjërues:

- **Besnik Tahiri**, Drejtor ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale
- **Agon Maxhuni, Drejtor Ligjor MAPL**
- **Fatmir Haxholli**, Ekspert i integritimeve GIZ
- **Rexhep Vasolli**, Ekspert I integritimeve, Ministria e Financave
- **Sehadin Shok**, Ekspert per te Drejtar e Njeriut

**Vendi: Hotel Otrant, Republika e Malit të Zi**

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, udhëheqës dhe përfaqësues të lartë të gjashtë komunave të Kosovës (Artanë, Junik, Han i Elezit, Obiliq, Ranillug dhe Viti), pjesë të projektit “Akademia për Qeverisje Lokale”, gjatë sesionit përmbyllës të gjeneratës së parë të ndjekësve të AQL-së folën për rolin e qeverisjes vendore në plotësimin e standardeve për Integritimet Evropiane.

Në Sesionin përmbyllës folën panelistët në përbërje, Rexhep Vasolli, ekspert i Integritimeve Evropiane pran Ministrisë së Financave, Fatmir Haxholli, ekspert i Integritimeve Evropiane, Agron Maxhuni nga Ministria e Pushtetit dhe Administrimit Lokal si dhe Drejtori i Institutit KLLGI, Besnik Tahiri.

Mysafiri ligjërues i sesionit përmbyllës të Akademisë për Qeverisje Lokale të mbajtur në Ulqin ishte edhe deputeti i Kuvendit të Republikës së Malit të Zi, Genci Nimanbegu. z.Nimanbegu foli për përvojat e Malit të Zi në lidhje me procesin e Integritimeve Evropiane. Më tej deputeti Nimanbegu tha se: Procesi për Integritimet Evropiane është mjaft kërkues ndaj vendeve pretendente dhe kandidate për anëtarësim në BE, i tillë ishte dhe vazhdon të jetë edhe për Malin e Zi. Pavarësisht kësaj, z.Nimanbegu tha se Mali i Zi në të gjitha nivelet po e jep maksimumin drejt plotësimin të standardeve të përcaktuara

Më tej Eksperti i Integritimeve Evropiane, pran Ministrisë së Financave, z.Rexhep Vasolli tha se: Procesi i Integritimit në BE nuk ishte asnjë herë më i fuqishëm se sa tani, pra ka trendë intensifikuese. Kemi pyetësorin e MSA dhe procesin e liberalizimit të vizave që konsiderohet se jemi në rrugën e mirë drejt integritimeve evropiane. Kjo tha ai për Kosovën paraqet një avancim për procesin dhe rritjen e obligimeve të

Kosovës karshi procesit. Faza e tanishme do të ketë intensifikim në plotësimin e kërkesave dhe standardeve sidomos nga niveli lokal.

Agron Maxhuni nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal foli për standardet ndërkombëtare të adoptuara në legjislacionin e brendshëm, ku tha se Këto standarde ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e jetës së qytetarëve të Komunave të Kosovës. Me tej ai vazhdoje se, Zbatimi i legjislacionit dhe parimeve të qeverisjes së mirë janë përgjegjësi e organeve te komunave që dalin nga zgjedhjet lokale. Partneriteti i qeverisë qendrore, qeverisë lokale, dhe instituteve të specializuara që merren më qeverisje lokale po ashtu ndikon në ofrimin e shërbimeve publike të qëndrueshme dhe cilësore për qytetaret e komunave. Z.Maxhuni përfundoj se Ky partneritet ndikon ne ngritjen e kapaciteteve lokale të strukturave politike dhe administrative në ofrimin e shërbimeve të kërkuara nga vet qytetaret.

Drejtori i Institutit KLGI, z.Besnik Tahiri foli për Qeverisjen Lokale dhe standardet ndërkombëtare të krijuara si nevojë për nivelin vendor të qeverisjes. z.Tahiri tha se: Komunat kanë rolë shumë të rëndësishëm në procesin e Integritimeve Evropiane dhe sidomos tani kërkohet angazhim maksimal i komunave të Kosovës për të ndihmuar integritet evropiane.

## Vizitë nivelit të qeverisjes lokale (Maqedoni, Shqipëri dhe Mal të Zi)

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (IKQL) ka ofruar një program substancial në fushën e qeverisjes lokale, që njihet si Akademia për Qeverisje Lokale (AQL), e para e këtij lloji në Republikën e Kosovës. AQL është dizajnuar të shërbejë si platformë dhe mënyrë e edukimit joformal për liderë komunalë të qeverisjes lokale

Si pjesë të projektit “Akademia për Qeverisje Lokale” (AQL), Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale organizoi vizitën studimore në tri shtete të rajonit: Maqedoni, Shqipëri dhe Mal të Zi. Në këtë vizitë morën pjesë drejtuesit dhe përfaqësuesit e lartë të gjashtë komunave të Republikës së Kosovës, vijues të AQL-së - Novobërdë, Junik, Hani i Elezit, Obiliq, Ranillug dhe Viti. Delegacioni u kryesua z. Besnik Tahiri, drejtor ekzekutiv i Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale.

Kjo vizitë studimore në rajon kishte për qëllim bashkëbisedimin me zyrtarë të lartë të qeverisjes lokale, takime me institucione qendrore, dhe vizita tjera në mënyrë që të njoftohemi me zhvillimet dhe reformat e suksesshme që vendet në rajon i kanë ndërmarrë si pjesë e procesit të integritimit evropian.

### **Komuna e Tetovës (Maqedoni):**

Pjesëmarrësit e AQL vizitën e tyre e nisën me Komunën e Tetovës në Maqedoni. Fillimisht ata u pritën nga kryetari i Komunës, z. Sadi Bexheti i cili i informoi ata për të arriturat, sfidat dhe përvojat e tij në drejtimin e komunës. Në takim me kryetarin z. Bexheti është me rëndësi të nënvizohet diskutimit në lidhje me ndikimin e dy universiteteve në emancipimin dhe zhvillimin lokal të kësaj komune.

Gjithashtu, pjesëmarrësit patën rastin që nga kryetari i komunës të informohen për rëndësinë e institucioneve të arsimit lartë në ngritjen e kapaciteteve institucionale të komunës. Në bashkëbisedim me kryetarin dhe zyrtarët e kësaj komune pjesëmarrësit diskutuan mbi praktikat demokratike, dhe veçanërisht zhvillimet e fundit të ndërmarra nga komuna me qëllim avancimin e pjesëmarrjes së femrës në vendimmarrje.

Në vazhdë të vizitës, pjesëmarrësit e AQL vizituan Universitetin e Evropës Juglindore, si institucion i lartë arsimor me kapacitet ndërkombëtar, ku me patën rast të informohen për rëndësinë që i ka dhënë komunës së Tetovës hapja e këtij universiteti.

Stafi akademik dhe administrativ i këtij Universiteti i njoftoi pjesëmarrësit në lidhje me programet akademike, përmbajtjen e tyre, numrin e studentëve vendor, nga rajoni dhe atyre ndërkombëtar si dhe formën e funksionimit. Si përfundim nga ky takim u konstatua se një universitet bashkëkohor sikurse universiteti në fjalë ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik lokal, në thellimin integritimin shkencor dhe kulturor mes qytetarëve të vendeve të rajonit, dhe gjithashtu ndikon në thyerjen e barrierave mes vendeve. Një fakt interesant ishte se një numër i madh i të diplomuarve në këtë universitet kanë arritur që në vendet prej nga vijnë, përfshirë edhe Kosovën të gjejnë hapësirë të mjaftueshme për t'u inkuadruar dhe kontribuar në jetën civile, institucionale dhe politike. Ndërsa një numër jo i pakët i tyre vazhdon studimet në universitetet perëndimore.

### **Bashkia Fier (Shqipëri):**

Drejtuesit dhe përfaqësuesit e lartë të gjashtë komunave të Republikës së Kosovës vizitën e tyre në Republikën e Shqipërisë e nisën me vizitën në Bashkinë e Fierit, me grast u pritën nga kryebashkiaku z. Baftjar Zeqaj. Kryebashkiaku Zeqaj bëri një prezantim të Fierit si qytet dhe si Qark, ku është ndalur më gjerësisht në burimet e naftës dhe bujqësisë. Sipas elaborimit të kryebashkiakut qyteti i Fierit si prioritet ka zhvillimin e turizmit kulturor, historik dhe arkeologjik.. Pjesëmarrësit u njoftuan që prioritetet e lartpërmendura janë të reflektuara në Planin Rregullativ të qytetit, si dhe strategjinë zhvillimore të tij.

Me këtë rast kryebashkiaku Zeqaj i informoi pjesëmarrësit e “Akademisë për Qeverisje Lokale” për mënyrën se si funksionojnë aktualisht hallkat në Bashkinë e Fierit, si në drejtim të investimeve, administratës, projektet prioritare në vazhdim dhe përvojat më të mira të Bashkisë. Me rëndësi vitale për qytetin dhe Bashkinë e Fierit është projekti bashkëpunues me KFË-në për ndërtimin e një impianti për ujërat e zeza, si dhe projekti për pastrimin e lumit Gjanica. Po ashtu, një detajim është bërë edhe për investimet aktuale përmes partneritetit publiko-privat, ku u vizituan disa projekte konkrete të kësaj natyre. Të pranishmit patën rastin që të shohin nga afër marrëdhëniet dhe lehtësirat që kanë bizneset private me Bashkinë.

Në lidhje me mënyrën e funksionimit të Këshillit Bashkiak të Fierit u ofrua një elaborim i hollësishëm nga nënkryetari i Këshillit të Bashkisë, Sokrat Ikonimi. Hapësirë të theksuar në këtë elaborim zuri rëndësia e koordinimit dhe bashkëveprimit të ngushtë në mes të Këshillit Bashkiak dhe vet Ekzekutivit të Komunës.

### **Bashkia Kamëz (Shqipëri):**

Pjesëmarrësit e AQL vizituan Bashkinë Kamëz ku u pritën nga Kryebashkiaku z.Xhelal Mziu. Kryebashkiaku Mziu, pasi u uroi mirëseardhjen miqve nga Kosova, bëri një prezantim të pozitës gjeografike si dhe të zhvillimit të vullshëm demografik, urban, ekonomik dhe social të Kamzës. z. Mziu theksoi se Kamëza është Bashkia e gjashtë në Shqipëri për numrin e popullsisë dhe e pesta për numrin e ndërtimeve.

Në Kamëz, pjesëmarrësve të AQL i'u prezantua një dokumentar substancial “Kamza, qendër e zhvillimit demografik, urban, ekonomik dhe social”. Ky dokumentar pasqyroi historikun e freskët të zhvillimeve në këtë qytet sikurse krijimi i infrastrukturës urbane dhe periferike, praktikatat e mira të qeverisjes lokale, marrëdhëniet me publikun dhe publikimet e bashkisë; praktikatat e buxhetimit me pjesëmarrje; bashkëpunimi me qeverisjen qendrore dhe me institucionet e organizmat ndërkombëtare; binjakëzimi i Kamzës me disa bashki e komuna të vendeve të BE-së e të rajonit; pjesëmarrja e Kamzës në programet evropiane; struktura e Këshillit Bashkiak dhe e administratës së bashkisë dhe veçanërisht investimet e realizuara në harkun kohor të pesë viteve të fundit.

Dokumentari dëshmon arritjet e Bashkisë dhe qytetit të Kamzës në fushat e infrastrukturës rrugore, ujësjellës-kanalizime, shkolla, pallat kulture, stadiumin e qytetit dhe terrenet sportive. Dokumentari u përcoll me pyetje të pjesëmarrësve të

AQL për zyrtarët përkatës të kësaj Bashkie lidhur me planet dhe projektet e ardhshme. Gjithashtu një hapësirë të theksuar të bashkëbisedimit zuri edhe çështja e përmirësimit të përfaqësimit të grave në Këshillin Bashkiak, legalizimi i ndërtimeve informale, infrastruktura shërbimeve. Kryebashkiaku i Kamzës z.Mziu u përqendrua në përvojat pozitive të Bashkisë Kamëz në lidhje me qeverisjen e mirë, modernizimin e infrastrukturës, përfshirë këtu efikasitetin e ofrimit të shërbimeve nëpërmes praktikës më bashkëkohore e njohur si ‘One Stop Shop’ .

### **Bashkia Tiranë (Shqipëri):**

Bashkia e fundit dhe më e rëndësishmja për nga kompleksiteti i administrimit dhe shtrirja e fushëveprimit e cila zgjoi interes të theksuar për pjesëmarrësit e AQL ishte vizita në Bashkinë e Tiranës. Me këtë rast pjesëmarrësit e AQL u pritën nga nënkryetari i Bashkisë z. Edmond Panariti. Të pranishmit, nën rryetari Panariti i njoftoi me projektet e fundit dhe të arriturat e Bashkisë së Tiranës, ku me theks foli për legalizimet e ndërtimeve informale dhe procedurat administrative.

Nënkryetari i Bashkisë dhe Kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës, ofroi një prezantim të hollësishëm në lidhje me sfidat, problemet dhe objektivat e kësaj Bashkie. Konkretisht në elaborimin e tij z. Panariti theksoi se prioritetet e Bashkisë së Tiranës janë zhvillimi ekonomik lokal, realizimi i të hyrave më të mëdha, realizimi i planeve urbane, me theks infrastrukturën, komunikacionin dhe gjelbërimin.

Nënkryetari i Tiranës tregoi se në praktikën e kryeqytetit është edhe përmirësimi i jetës së qytetarëve që ju përkasin grupeve të cenuara sikurse janë moshat e shtyra, fëmijët dhe të rinjtë. Për këtë qëllim z. Panariti thotë se do të ofrohen banesa sociale për një numër të qytetarëve që i përkasin këtyre shtresave. Sipas vlerësimit të Panaritit është tejet e volitshme që Bashkia Tiranë të ju ofrojë këtyre qytetarëve edhe mundësin e blerjes së këtyre banesave sociale me kredi me nivel të ulët të interesit. Gjithashtu, Tirana aplikon praktikën e ofrimit të transportit publik falas për moshat e shtyra, ndërsa pritet që së shpejti të ofrojë lehtësira edhe për ata të cilët mbajnë kartë studenti.

Z. Panariti shpjegoi që me qëllim të shkarkimit të komunikacionit, Tirana është duke ndërtuar parkingje nën tokësore dhe njëkohësisht është duke aplikuar qarkullimin e mjeteve të rënda në rrugë periferike. Ndërsa për një kohë të shkurtër parashihet ndërtimi i dy akseve të qarkullimit me tramvaj të cilat do të kryqëzohen brenda qytetit dhe në këtë mënyrë qytetarë nga lagje të ndryshme si dhe ata të cilët vizitojnë shkurt këtë qytet do të mund të udhëtojnë shumë më shpejtë dhe me më pak vështirësi. Një element tjetër me rëndësi për këtë Bashki u përmend edhe zgjerimi i hapësirave të gjelbëruara si dhe rregullimin e sheshit kryesor të kryeqytetit. Takimi u përmbyll me diskutime në lidhje me grantet e ofruara nga niveli qendror që si u tha zhvillimet politike në Shqipëri konfirmojnë parimin që qeverisja nga forcat e njëjta politike në nivel qendror dhe atë lokal ofron më shumë bashkëpunim.

### Ulqin (Mali i Zi):

Gjatë vizitës disa ditore në Maqedoni, Shqipëri, dhe Mal të Zi pjesëmarrësit e AQL vizituan edhe Komunën e Ulqinit ku me që rast u priten nga kryetari i Komunës, z. Nazif Cungu.

z. Cungu u ndal në shtjellimin e angazhimeve të tij si dhe administratës së Komunës në stimulim të turizmit dhe nevojën që në kuadër të strategjisë komunale, turizmi bregdetar të bëhet një prioritet themelor. Z. Cungu u ndal në veprimet që ai dhe forca politike e cila qeverisë me Komunën e Ulqinit kanë ndërmarrë me qëllim realizimin e reformave dhe zhvillimin e kësaj komune. z. Cungu nënvizoi që ardhja e tij në krye të Komunës ka konstatuar një numër të madh të ngecjeve dhe sfidave esenciale. Konkretisht kësaj Komune i kanë munguar planet strategjike dhe planet e veprimit, ndërsa kjo ka rezultuar me qeverisje arbitrare të cilës i ka munguar legjitimiteti demokratik, për çka komuna ka pasur problem në realizimin e të hyrave si dhe në përfshirjen e qytetarëve.

z. Cungu përmendi se udhëheqja e tij bazohet në frymën dhe eksperiencën e cila si model ka korporatat e suksesshme dhe shpirtin ndërmarrës. Nisur nga kjo paradigmë z. Cungu theksoi se ai me ardhje në krye të Ulqinit i përkrahur nga gjithë struktura komunale ka përgatitur planin zhvillimor dhe strategjik të kësaj Komune, diçka që sipas tij do të rezultojë me vendosjen e rregullit urbanistik, me përmirësimin e kushteve për vizitorët, si dhe me ngritjen e të ardhurave nga taksat e ndërtimit.

Nisur nga kjo pikëpamje z. Cungu shpjegoi se në qeverisjen me Komunë ai do të vendos parimin e funksionimit të stafit në bazë të nevojës për ofrim të shërbimeve, diçka që sipas tij do të ndikojë në ngritjen e efikasitetit dhe reduktimin e shpenzimeve buxhetore. Më konkretisht kryetari i Ulqinit shpjegoi se ai angazhohet për praktikën që stafi i Komunës të jetë vetëm ai staf për të cilin komuna ka nevojë, ndërsa të tjerëve nuk do të ju vazhdohet kontrata. Për më shumë Cungu përmendi edhe uljen për 30% të pagave të stafit të Komunës, kjo me qëllim që qytetarët të njoftohen se kjo qeverisje synon të ekonomizojë shpenzimet.

Të gjitha këto praktika sipas z. Cungut mundësojnë forcimin e legjitimitetit të qeverisjes si dhe zgjimin e interesit qytetar në lidhje me rolin e komunës dhe përfshirjen e tyre në këto procese. Cungu përmendi edhe evidentimin e borxheve dhe fillimin e shlyerjes së tyre. Kjo është bërë nëpërmes paralajmërimit të atyre të cilët nuk kanë shlyer borxhet dhe ofrimin e mundësisë që këto borxhe të shlyhen në mënyrë fleksibile dhe progresive. Ndërsa për ata qytetarë të cilët nuk shlyejnë borxhet komuna do të ndërmarrë sanksione sikurse parashihet me ligj. Pas këtij takimi mysafirët nga Kosova shfrytëzuan rastin të vizitojnë edhe pllakën përkujtimore e cila u ngrit nga qytetarët e Kosovës në shenjë të respekti dhe mirënjohjes ndaj popullatës së Ulqinit në strehimin e refugjateve nga Kosova në kohën e luftës.

Po ashtu, delegacioni i gjashtë komunave të Kosovës vizitoi edhe ndërmarrjet publike, me qëllim të njohjes së praktikave të funksionimit të tyre. Nga vizita që iu bë ndërmarrjes së pastrimit dhe gjelbërimit, si dhe asaj të ujësjellësit u diskutua në lidhje me ngritjen e nivelit të vetëdijes në lidhje me shfrytëzimin racional të ujit nga ana e qytetarëve, si dhe rëndësinë që praktika e ri-ciklimit ka për një vend modern. Me këtë rast udhëheqësit e këtyre ndërmarrjeve si dhe pjesëmarrësit u pajtuan që për të dy këto



aspekte - shfrytëzimi racional i ujit, dhe riciklimi - ndërlidhen ngushtë me qytetarinë e përgjegjshme dhe aktive. Thënë ndryshe një shoqëri e informuar dhe edukuar i kushton vëmendje mënyrës se si e trajton ambientin dhe se si i shfrytëzon burimet natyrore. Udhëheqësit e kompanive në fjalë shprehën shqetësimin e tyre për mungesën e fondeve për realizimin e projekteve strategjike sikurse është shtimi i kapacitetit të furnizimit me ujë të qytetit, apo edhe blerja e pajisjeve për mbledhje dhe transportim të mbeturinave.

## **Takimet me nivelin qendror – Qeveria e Shqipërisë**

### **Takimi me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, z. Sali Berisha**

Kryeministri Berisha, duke shprehur vlerësimin për këtë projekt, theksoi rëndësinë dhe dobinë e vendosjes së një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet dy vendeve në fushën e qeverisjes vendore. Ai shprehu bindjen se qeveritarët vendorë të të dyja vendeve mund të shkëmbejnë përvojat e tyre dhe t'i zbatojnë ato me sukses në komunat respektive, në interesin më të mirë të komuniteteve që ata drejtojnë. Qeveritarët vendorë, tha Kryeministri, janë ata që lidhen direkt me njerëzit dhe me veprimtarinë e tyre, dhe që kanë ndikim direkt në jetën e tyre dhe të komunitetit në tërësi.

Në bashkëbisedim me ta, Kryeministri Berisha u ndal në disa nga reformat themelore në forcimin e kapaciteteve dhe kompetencave të pushtetit lokal. Kryeministri theksoi se qeveria ka rritur 4 deri në 5 herë financimin për qeveritë vendore dhe është e gatshme të mbështesë me financime projektet e qeverisë vendore. Më tej kryeministri i njohu ata me investimet e bëra në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe me programin ambicioz të ndërtimit dhe rindërtimit të një rrjeti të ri rrugor. Në këtë aspekt, Kryeministri vlerësoi rëndësinë jetike që kanë pasur qeveritë vendore për realizimin e këtij projekti.

Duke u ndalur në disa nga reformat, të cilat kanë rezultuar të suksesshme, si One Stop Shop për regjistrimin bizneseve, lejeve dhe licencave, për lehtësimin e burokracisë administrative dhe rritjen e transparencës, Kryeministri tha se është shumë pozitive që këto modele po ndiqen edhe nga pushteti vendor. “Pushteti vendor po përpiqet gjithashtu të krijojë sportelin unik të shërbimit të qytetarëve, ku qytetari të gjejë të gjitha shërbimet që i nevojiten dhe shpresoj që gradualisht të fillojë të funksionojë në Shqipëri ky sportel, falë teknologjisë digjitale” veçoi kryeministri Sali Berisha.

z. Besnik Tahiri në cilësinë e organizatorit të vizitës si dhe ofrimit të programit të AQL u ndal në ri-theksimin e rëndësisë së reformave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Në mes tjerash z. Tahiri nënvizoi modernizimin e administratës, ngritjes së transparencës dhe, mbi të gjitha, stimulimin e zhvillimit lokal.

Kryeministri shprehu kënaqësinë që të pranishëm në këtë takim ndodheshin edhe përfaqësuesit e minoriteteve në Kosovë dhe njëkohësisht vlerësoi kontributin që ata japin për komunitetet e tyre, por edhe vullnetin dhe vendosmërinë e bashkëjetesës për paqen dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon. Kryeministri shprehu besimin se ata do të gjejnë tek bashkitë e komunat në Shqipëri partnerë shumë të dobishëm. Në takim me kryeministrin Berisha foli edhe kryetari i Komunës së Ranillugut, z. Gradimir Mikiq i cili falënderoi kryeministrin e Republikës së Shqipërisë për kontributin e tij në avancimin e pozitës së Komunave të cilat drejtohen nga komunitetet jo-shumicë në Republikën e Kosovës dhe shprehu interesin e tij për binjakëzim të Komunës së Ranillugut me Bashkitë apo Komunat në Shqipëri.

## Ministria e Integritimeve Evropiane – takimi me Ministren Majlinda Bregu

Gjatë qëndrimit në Shqipëri pjesëmarrësit e AQL vizituan Ministrinë e Integritimit Evropian, dhe u takuan me ministren, znj. Majlinda Bregu. Me këtë rast pjesëmarrësit u njoftuan rreth procesit të integritimit evropian të Republikës së Shqipërisë e sidomos rreth rolit të rëndësishëm që komunat kanë në këtë proces të rëndësishëm për Shqipërinë dhe, po ashtu, për Kosovën.

Në fokus të bashkëbisedimit me ministren Bregu ishin edhe marrëdhëniet mes nivelit qendror dhe atij lokal të qeverisjes në kuadër të menaxhimit të fondeve strukturore të Bashkimit Evropian. Duke iu referuar përvojës shqiptare në menaxhimin e fondeve të IPA-s, ministrja Bregu tha se është shumë e rëndësishme cilësia e hartimit të projekteve me të cilat konkurron një bashki apo komunë. Përveç kësaj, vend të veçantë zë edhe menaxhimi siç duhet i fondeve dhe implementimi i projekteve me cilësi dhe në kohën e duhur.

Ajo konfirmoi fuqishëm angazhimin dhe ndihmën e Qeverisë së Shqipërisë për komunat e Kosovës, në veçanti përmes programeve të bashkëpunimit ndërkuftar dhe shfrytëzimit të fondeve të Komisionit Evropian. Më tej ajo theksoi se komunat duhet të kenë një vizion të qartë dhe të punojnë me përpikëri, në mënyrë që standardet që duhet t'i përmbushin, të jenë në funksion të agjendës kombëtare për integrim.

Ministrja theksoi se është me rëndësi për nivelin lokal që të investojë në projekte strategjike dhe afatgjate, dhe këto projekte mund të gjejnë përkrahje nga ana e fondeve të Bashkimit Evropian. Por sipas ministres nevojitet një koordinim i mirëfilltë mes nivelit qendror dhe atij vendor në mënyrë që përgatitja e projekteve, aplikimi për fonde, përfitimi i tyre, si dhe realizimi i kësaj përkrahje të mos humbet në proces. Në praktikën e përkrahjes së vendeve aspirantë sipas ministres, institucionet e Bashkimit Evropian kërkojnë nga instancat vendore dhe qendrore të vendeve të Ballkanit që të mund të sigurojnë për menaxhimin e shëndosh të financave, raportimin e tyre, si dhe të sigurojnë impakt. Për këtë qëllim nevojitet përkrahje e kapaciteteve funksionale dhe profesionale të komunave nga ana e nivelit qendror, por njëkohësisht dhe paralelisht niveli vendor duhet të demonstrojë përgjegjshmëri kur është fjala për zbatimin e kompetencave që i takojnë – në këtë kuadër duhet më shumë transparencë, llogaridhënie kundrejt qytetarit, ndërsa në raport me nivelin qendror kërkohet bashkëpunim më i ngushtë dhe koordinim i veprimeve. Znj. Bregu shfaqti përkushtimin e vendosur të institucionit që ajo drejton që të përkrah nivelin qendror dhe nivelin lokal të qeverisjes në Republikën e Kosovës. Për këtë qëllim shprehu ajo ne inkurajojmë shkëmbime më intensive si në nivel të komunikimit ashtu edhe në nivel të shkëmbimit të praktikave.

## Ministria e Ambientit – takimi me Ministrin Fatmir Mediu

Pjesëmarrësit e AQL vizituan edhe Ministrinë e Ambientit të Republikës së Shqipërisë ku u priten nga z. Fatmir Mediu, ministër. Ministri Mediu i informoi të pranishmit me punën e ministrisë ku theksoi rëndësinë e madhe që kanë komunat në mbrojtjen e ambientit e në veçanti, në menaxhimin dhe kontrollin e pyjeve si dhe shfrytëzimin racional të ujit si e mirë publike. Ministri fuqishëm rekomandoi organizmin e një tryeze me karakter rajonal për menaxhimin e ujit si e mirë publike e vendeve të rajonit. Një temë që zgjoi interes ishte menaxhimi dhe mbrojtja e pyjeve si dhe trajtimi i tyre, si në aspektin ekologjik, po ashtu edhe për turizëm e mbi të gjitha për stimulimin e zhvillimit ekonomik lokal nëpër komuna.

Ministri Mediu theksoi rëndësinë e integritetit të planeve në fushën e ambientit si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Një praktikë e mirë e cila ka rezultuar plotësisht e suksesshme si në menaxhimin ashtu edhe në mbrojtjen e pyjeve sipas ministrit është ofrimi i pyjeve në pronësi të komunave. Një element tjetër tejet i rëndësishëm për ambientin u theksua praktika e ndërlidhjes së zhvillimit rural me planifikimin e ambientit, përfshirë menaxhimin e pyjeve. z. Mediu theksoi se qëllimi i tij dhe i ministrisë që ai drejton ka qenë kthimi i ambientit në një prioritet nacional diçka që nuk ka qenë më parë. Për rrjedhojë kjo ka filluar të ofrojë rezultatet e para, dhe tani kemi iniciativa të cilat po ndryshojnë gjendjen në bregdetin Shqiptar. Një praktikë tjetër e rëndësishme për zhvillimet në fushën e ambientit në Shqipëri është ndarja e dimensionit të inspektimit prej atij të planifikimit të politikave – diçka që mundëson rezultate konkrete në terren.

## **Përfundime dhe praktikat e mira për t'u vënë në zbatim konkret nga komunitat në Kosovë**

Këto do të ishin përfundimet dhe praktikat e mira të përfituara nga kjo vizitë që do të mund të përshtaten në kontekstin lokal të secilës nga komunitat që patën rastin të jenë pjesëmarrës në AQL dhe këtë vizitë. Në lidhje me këto përfundime dhe praktika, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale shpreh gatishmërinë që të përkrah komunitat me informacion shtesë, me interpretimin dhe elaborimin e tyre të hollësishëm, si dhe me përkrahje të drejtpërdrejt profesionale dhe operacionale e cila do të mundësonte zbatimin e tyre në terren.

### **Përfundimet dhe Praktikrat:**

- Krijimi i parakushteve për shkollim të lartë universitar ndikon në zhvillimin ekonomik lokal si dhe rritjen;
- Komunitat duhet të angazhohet në stimulimin e edukimit profesional dhe sidomos në programe që kanë si fokus qeverisjen, në këtë drejtim ato duhet të eksplorojnë mundësi të përkrahjes së talenteve dhe liderëve të rinj. Kjo përkrahje duhet të kushtëzohet me një mirëkuptim reciprok mes përfituesit/ve dhe komunitat në mënyrë që në një formë apo tjetër komunitat të mund të përfitojnë nga kontributi i përfituesve;
- Duhet të ndërmerren masa dhe të aplikohen praktika të cilat sigurojnë avancimin e rolit të femrës në vendimmarrje lokale;
- Duhet sinkronizuar vendosjen e prioriteteve lokale me plane strategjike dhe urbanistike, si dhe me dokumente tjera rregullative;
- Një vëmendje të veçantë i duhet kushtuar turizmit kulturor, historik dhe arkeologjik. Komunitat mund të realizojnë të hyra të drejtpërdrejta si dhe të promovojnë zhvillimet lokale nëpërmes turizmit;
- Një vend të veçantë në lidhje me zhvillimin ekonomik lokal, si dhe në mirëqenien e përgjithshme të komunitave zënë biznese dhe marrëdhëniet me to. Në këtë kuadër bizneseve lokale duhet ofruar parakushte të volitshme për regjistrim dhe funksionim, si dhe lehtësira tatimore;
- Komunitat duhet të tregohen më proaktive kur është fjala të ndërtimeve të profilit në kuadër vendi dhe jashtë. Për këtë qëllim Komunitat duhet identifikuar mundësitë e binjakëzimit dhe bashkëpunimit si brenda vendit ashtu edhe jashtë. Kjo është në fushëveprimin e komunitave dhe nuk duhet pritur që të tjerë akter t'i ofrojnë shërbime të mira komunitave në këtë drejtim;
- Komunitat duhet të ofrojnë shërbimet në mënyrë efikase, dhe për këtë qëllim praktika – one stop shop- është treguar shumë efikase dhe demonstruar vlera tjera shtesë;
- Ngritja e vetëdijes së përgjithshme nëpërmes fushatave informative me qëllim shfrytëzimin racional të burimeve natyrore si dhe me qëllim të ndërgjegjësimit

për trajtimin sa më të duhur të ambientit, përfshirë këtu rëndësinë e riciklimit të mbeturinave;

- Komunat duhet të eksplorojnë mundësi për ofrimin e lehtësirave për qytetarët të cilët ju takojnë shtresave më të pa favorizuara nga rrethanat;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë me nivelin qendror është parakusht themelor për mirë funksionimin e qeverisjes lokale;
- Komunat duhet të eksplorojnë mënyrat më të suksesshme të menaxhimit me staf dhe aktivitete, në mënyrë që të shtohet kredibiliteti para qytetarëve dhe të fuqizohet legjitimiteti dhe demokracia lokale;
- Komunat me qëllim të demonstrimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies duhet të bëjnë transparente secilin shpenzim, si dhe duhet të reduktojnë shpenzimet, në rast nevojë duhet të ri-programojnë angazhimin e stafit. Vetëm stafi në shërbim dhe i angazhuar duhet të angazhohet më kontratë afatgjatë;
- Komunat duhet kushtuar interes të veçantë realizimit të të hyrave nga taksat, nga menaxhimi i pasurisë si dhe nga bashkëpunimi publiko privat;
- Komunat duhet evidentuar borxhlinjtë, duhet përcjellë trendet e shlyerjes së borxheve, duhet ofruar skema fleksibile për shlyerje të borxheve, dhe duhet kushtëzuar shlyerjen e borxheve me ofrimin e shërbimeve konform me respektimin e të drejtave themelore të njeriut, dhe në pajtim me ligjin për qeverisje lokale dhe kushtetutën;
- Komunat në varësi të kapaciteteve duhet të ofrojnë strehim për numrin e qytetarëve që janë më së shumti të prekur nga gjendja e vështirë sociale;
- Komunat duhet të kërkojnë përkrahjen e nivelit qendror në lidhje me familjarizimin më të madh me fondet e IPA-s si dhe me vendosjen e projekteve që do të aplikojnë për përkrahje;


#### **Për nivelin qendror:**

- Përfundimet dhe praktikat:
- Duhet fuqizuar paradigma që janë të zgjedhurit lokal ata të cilët janë të lidhur me njerëzit dhe që ndikojnë në jetën e tyre;
- Duhet rritur financimi për nivelin lokal;
- Duhet angazhuar në projekte afatgjate të cilat do të ndikonin në stimulimin e zhvillimit ekonomik lokal;
- Duhet mundësuar reformat të cilat sigurojnë një terren ku qeverisja lokale është efikase;
- Duhet koordinuar veprime në lidhje me integrimin evropian të vendit, dhe rolin e strukturave të qeverisjes lokale në këtë kontekst;
- Aplikimi për fonde të IPA-s duhet të përfshijë sa më shumë komunat si aplikant;
- Në procesin e integritit evropian, përfaqësuesit e komunave duhet përfshirë në vizita studimore dhe programe trajnimit, edukimi;

- Duhet mundësuar më shumë kontroll dhe balans mes degëve si brenda ashtu edhe ndër institucionale, dhe për këtë qëllim duhet shmangur koncentrimi i kompetencave të cilat mund të rezultojnë me konflikt interesi.

### **Informacion dhe falënderim**

Kjo vizitë studimore u mbështet financiarisht nga Ambasada Norvegjeze në Republikën e Kosovës dhe me logjistikë rreth takimeve nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Tirana. Vizita si e tillë është pjesë e programit “Akademia për Qeverisje Lokale”, që është program edukativ i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale, i mbështetur nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, Këshilli Britanik dhe Fondacioni FES, zyra në Kosovë.



Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale  
Address: Rexhep Luci, 15/6 Prishtinë, Kosovë, 10000  
E-mail: [klg.institute@gmail.com](mailto:klg.institute@gmail.com)  
Tel: +381 38 225 625 or 044-640164  
Web faqja: [www.klg-institute.org](http://www.klg-institute.org)